

RAPORTI PERFUNDIMTAR

I

GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

TË UNIVERSITETIT EPOKA

Programet e studimit:

1. DND Inxhinieri Kompjuterike
2. MND Inxhinieri Kompjuterike

Eksperti: Prof. Dr. Thoma Korini

Maj 2012

Tabela e lëndës

Tabela e lëndës	2
Hyrje.....	6
Përbërja e GVJ.....	6
Parimet e Punës së GVJ.....	7
Të dhëna për programin e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike	7
a) Të dhëna të përgjithshme për Universitetin EPOKA.....	7
b) Të dhëna për programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike	10
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE.....	11
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	11
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	12
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	14
Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.	14
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.	14
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	15
Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	16
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	16
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.....	17
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.....	17
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënës.	19
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.....	20
Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.	20
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I INSTITUCIONIT BËHET NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE.	21
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	21
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	21
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	23

Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.....	23
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.....	24
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.....	25
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.....	25
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.....	26
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.....	27
III - PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PËRBËHET NGA PERSONELI AKADEMIK, PERSONELI NDIHMËS MËSIMORSHKENCOR DHE PERSONELI ADMINISTRATIV.....	28
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.....	28
Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.....	30
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.....	31
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.....	31
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.....	32
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.....	32
Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.....	33
Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.....	33
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.....	34
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.....	34
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.....	35
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	35
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.....	35
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.....	36

Standardi IV. 3 - Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.....	37
Standardi IV. 4 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	37
Standardi IV. 5 - Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.	38
Standardi IV. 6 - Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.....	38
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI.....	39
Standardi V. 1 - Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.....	39
Standardi V. 2 - Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.	39
Standardi V. 3 - Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	40
VI - INSTITUCIONI KA DHE MENAXHON BURIMET FINANCIARE	41
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.....	41
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDASHME DHE TË JASHTME	41
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet... ..	41
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.....	42
VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË	43
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve....	43
Analiza SWOT për implementimin e programit të studimit.....	44
KONKLUZION.....	47

SHKURTIME

FAI	Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë
FSEA	Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative
APAAL	Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
SWOT	(Strength, Weakness, Opportunities, Threats) Pikat e Forta, Pikat e Dobëta, Oportunitet dhe Kërcënimet)
KVAPC	Këshillit të Vlerësimit Akademik dhe Përmirësimit të Cilësisë.
GVB	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
RVB	Raporti i Vlerësimit të Brendshëm
GVJ	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm
RVJ	Raporti i Vlerësimit të Jashtëm

Hyrje

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u kontraktua nga Agjencia e Akreditimit të Arsimit të Lartë për të bërë vlerësimin e jashtëm programort të Universitetit Epoka. Qëllimi i procesit të vlerësimit të jashtëm është të japë një mendim të pavarur për shkallën në të cilën institucioni në fjalë është i përgatitur dhe i angazhuar të përmbushë me efektivitet dhe përgjegjshmëri kërkesat dhe standardet akademike të diplomave që do të lëshojë. Për të arritur në këtë gjykim, GVJ u mbështet në shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në dokumentacionin bazë mbi të cilin ngrihet veprimtaria e Universitetit (statuti, rregullorja, etj), dosjet e programeve të studimit, tre regjistrat bazë të përcaktuar nga udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH), dokumentacioni i zyrës së burimeve njerëzore, etj. Po ashtu, GVJ pati mundësinë të bisedojë me rektorin, drejtuesit dhe anëtarët e trupave kolegjiale, stafin akademik, studentët, punonjësit e sekretarisë mësimore etj. Vizita u bënë në mjediset e universitetit, përfshirë bibliotekën, sallat e kompjuterëve dhe laboratorët.

Vlerësimi i programeve të studimit u fokusua në analizën e programeve të studimit, në shqyrtimin e sillabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kompetencën e stafit pedagogjik, etj.

Universiteti Epoka ka **dy fakultete**: Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë dhe Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Administrative. Universiteti ka në strukturën e vet edhe një numër Qendrash Kërkimore (kryesisht të integruara në fakultetet përkatëse) si:

- Qendra e Studimeve Europiane
- Qendra Kërkimore për Tërmetet dhe Teknologjitë e Ndërtimit
- Qendra për Kërkime dhe Aplikime
- Qendra e Kërkimit dhe Aplikimit mbi Menaxhimin e Cilësisë
- Qendra e Formimit të Vazhduar dhe Planifikimit të Karrierës.

Universiteti Epoka me strukturat dhe infrastrukturën mësimore siguron një lidhje shumë të mirë midis mësimdhënies dhe kërkimit, çka është edhe një ndër kërkesat bazë që duhet të përmbushin institucionet që ofrojnë programe mësimore të të dy cikleve e që synojnë të angazhohen edhe në ciklin e tretë.

Përbërja e GVJ

1. Znj. Albana Harshova
2. Znj. Etleva Leskaj
3. Znj. Eva Hyskaj
4. Z. Ferit Duka
5. Z. Gjergj Thomai
6. Z. Thoma Korini
7. Z. Petrit Dollani
8. Z. Fisnik Kadiu

9. Z. Hysen Çela
10. Znj. Ilira Sulo

Parimet e Punës së GVJ

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte **Raporti i Vetëvlerësimit**, i hartuar në Tetor 2011 nga vetë institucioni. Ky raport siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti Epoka për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Universiteti, po ashtu, vuri në dispozicion të vlerësuesve një numër dokumentesh shtesë si dhe u administruan *Rezultatet e Pyetësorëve* të studentëve.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga *Ligji Nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, *Udhëzimi Nr. 15, datë 4.4.2008 "Për organizmin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, Udhëzimi Nr. 30, datë 26.09.2008 datë 28.07.2008 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacioni që duhet të paraqesë subjekti juridik për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë ose programeve të studimit, në ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve si dhe programeve të studimeve "Master i Nivelit të Dytë"*. Të gjitha këto materiale u vunë në dispozicion nga APAAL.

Në takimin e parë të tij pasi ishte njohur në mënyrë individuale me këto materiale, ekipi diskutoi gjerësisht mbi *Raportin e Vetëvlerësimit* dhe, i ndihmuar nga stafi i APAAL, hartoi një program takimesh që do të realizoheshin gjatë vizitave në Universitetin Epoka.

GVJ e vizitoi Universitetin në mënyrë të organizuar në muajin shkurt 2012. Secili prej anëtarëve të grupit ka pasur mundësinë të vizitojë njësitë e ndryshme të universitetit edhe në mënyrë individuale.

GVJ zhvilloi diskutime me rektorin, dekanët, stafin akademik të departamenteve si dhe me pedagogë të veçantë. GVJ u ndal në detaje të funksionit të sekretarisë mësimore të Universitetit si dhe në detaje të administrimit të jetës së universitetit. Ekipi vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si sallat e internetit dhe të kompjuterave, bibliotekën, mjediset e studimeve, etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh dhe u administrua një pyetësor (sipas modelit të APAAL). Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave.

Të dhëna për programin e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike

a) Të dhëna të përgjithshme për Universitetin EPOKA

Universiteti ka filluar procesin mësimor në vitin 2007 me dy fakultete: Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë (FAI) dhe Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Administrative (FSEA).

Edhe pse Universiteti Epoka është bazuar në sistemin amerikan të arsimit të lartë, ai ka adoptuar në të njëjtën kohë edhe kreditet ECTS, të cilat përbëjnë një element kyç në procesin e Bolonjës. Gjithashtu, arsimi në gjuhën angleze në Universitetin Epoka lehtëson lëvizjen e studentëve të universitetit në kuadër të EHEA-së, si dhe atë të studentëve të huaj drejt Universitetit Epoka.

Programet e studimit të ciklit të dytë të ofruara nga Universiteti Epoka janë:

- **Programe studimi të ciklit të dytë me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe 120 ECTS:**

- Financë-Bankë në përfundim të të cilave akordohet Diplomë e Nivelit të Dytë (sot Master i Shkencave);
 - Administrim Biznesi në përfundim të të cilave akordohet Diplomë e Nivelit të Dytë (sot Master i Shkencave);
 - Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në përfundim të të cilave akordohet Diplomë e Nivelit të Dytë (sot Master i Shkencave);
 - Inxhinieri Ndërtimi në përfundim të të cilave akordohet Diplomë e Nivelit të Dytë (sot Master i Shkencave);
 - Inxhinieri Kompjuterike në përfundim të të cilave akordohet Diplomë e Nivelit të Dytë (sot Master i Shkencave);
 - Arkitekturë në përfundim të të cilave akordohet Diplomë e Nivelit të Dytë (sot Master i Shkencave).
- **Programe studimi të ciklit të dytë me kohëzgjatje 1 vit akademik dhe 60 ECTS:**
- Financë-Bankë, në përfundim të të cilave akordohet Diplomë Master i Nivelit të Dytë (sot Master Profesional);
 - Administrim Biznesi, në përfundim të të cilave akordohet Diplomë Master i Nivelit të Dytë (sot Master Profesional);
 - Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në përfundim të të cilave akordohet Diplomë Master i Nivelit të Dytë (sot Master Profesional);
 - Studime Europiane, në përfundim të të cilave akordohet Diplomë Master i Nivelit të Dytë (sot Master Profesional);
 - Inxhinieri Ndërtimi, në përfundim të të cilave akordohet Diplomë Master i Nivelit të Dytë (sot Master Profesional);
 - Inxhinieri Kompjuterike, në përfundim të të cilave akordohet Diplomë Master i Nivelit të Dytë (sot Master Profesional);
 - Arkitekturë, në përfundim të të cilave akordohet Diplomë Master i Nivelit të Dytë (sot Master Profesional).

Gjithashtu, Universiteti Epoka ofron forma të kualifikimit të vazhdueshëm nëpërmjet trajnimeve me certifikatë.

Programet e studimeve në Universitetin Epoka janë duke u përshtatur me *Ligjin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Nr. 9741, datë 21.05.2007 i ndryshuar*, i cili përcakton programet e studimeve “Master i shkencave” dhe “Master profesional” si programe studimi të ciklit të dytë.



Strukturat, studentët dhe stafi:

Struktura akademike e Epoka përbëhet nga:

1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë (FAI)

1. Departamenti i Arkitekturës
2. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit
3. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike

2. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative (FSEA)

1. Departamenti i Ekonomiksit
2. Departamenti i Administrim Biznesit
3. Departamenti i Financë Bankës
4. Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare

3. Qendrat Kërkimore

1. Qendra e Studimeve Europiane
2. Qendra Kërkimore për Tërmetet dhe Teknologjitë e Ndërtimit
3. Qendra për Kërkime dhe Aplikime
4. Qendra e Kërkimit dhe Aplikimit mbi Menaxhimin e Cilësisë
5. Qendra e Formimit të Vazhduar dhe Planifikimit të Karrierës.

Çdo fakultet ka **3 deri në 4 njësi bazë** (departamente) nga 3 të kërkuara minimalisht nga ligji. Në shërbim të tyre janë edhe Qendrat Kërkimore të cilat garantojnë mësimdhënien nëpërmjet kërkimit shkencor dhe shërbejnë për të nxitur pjesëmarrjen në kërkim shkencor si të stafit akademik të Universitetit Epoka ashtu edhe të studentëve.

Numri i stafit me kohë të plotë i angazhuar në programet Master të Universitetit Epoka është 30 dhe me kohë të pjesshme 16. Pra përqindja e stafit akademik me kohë të plotë e angazhuar në programet Master është 65.2%, ndërsa e atij me kohë të pjesshme 34.8%. Nga totali prej 46 i stafit akademik të Universitetit Epoka angazhuar në programet Master, 100% e tyre zotërojnë së paku gradën shkencore “Doktor”, ndërkohë që 16 (35%) anëtarë të stafit akademik zotërojnë titullin “Profesor” dhe 3 (7.5%) titullin “Prof.Asoc”. Kjo masë garanton edhe përmbushjen e standarteve që lidhen me kualifikimin shkencor-akademik të stafit.

b) Të dhëna për programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike

Programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike mbulohen nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, pjesë e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë.

Misioni i Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike është që të edukojë studentët me njohuritë bazë të shkencës dhe teknikës në mënyrë që ata të mund të zhvillojnë zgjidhje për problemet e inxhinierisë kompjuterike si dhe për të rritur aftësitë e tyre në shkencat kompjuterike, arkitekturës së kompjuterit, dizajnit dhe analizës së algoritmeve, programimit të softwareve, komunikimit dhe aftësive hulumtuese. Departamenti ka për qëllim të inkurajojë sidomos punën në grup, punën e pavarur dhe të menduarit inovativ si dhe cilësitë e drejtuesit.

Kreditet që duhet të plotësohen për të përfunduar me sukses programin Master Profesional (MND) janë 60 ECTS, ndërsa për Master Shkencash (DND) janë 120 ECTS. Kohëzgjatja për programin Master Profesional (MND) është 1 vit, ndërsa për programin Master Shkencash (DND) është 2 vjet.

Në industrinë globale ka një kërkesë të madhe për inxhinierë kompjuteri, në mënyrë të veçantë të atyre që kombinojnë aftësitë teknike me aftësitë e komunikimit të mirë dhe të punës në grup.

Mundësitë për punësim mund të përmbliken si vijon:

- I punësuar si lektor ose studiues në universitete apo qendra kërkimore;
- I punësuar në kompani të tilla si: banka, industri ajrore, departamente qeveritare, kompani konsultash dhe organizata kompjuterike që punojnë me sisteme kompjuterike të mëdha si dhe firma të specializuara në sektorin e paisjeve kompjuterike;
- Implementimi i të dhënave në sistemet e komunikimit dhe teknologjive të internetit;
- Projektimi i komponentëve për zhvillimin e hardwareve dhe kartave të rrjeteve për sistemet kompjuterike;
- Menaxhimi i projekteve dhe programeve të nivelit të lartë të zhvillimit;
- Ruajtja dhe administrimi bazave të shpërndara të të dhënave dhe rrjeteve lokale të koropratave.

Objektivat programeve të studimit janë “pajisja” e të diplomuarve të ciklit të parë me njohuri të shëndosha në:

- programim (tradicional, të orientuar nga objekti dhe për zbatime informatike të gjithanëshme);
- inxhinieri rrjetash kompjuterike;
- aplikimesh Web dhe Baza të Dhënash;
- projektim dhe mirëmbajtje të sistemeve të informacionit.

Për mbulimin e programeve të studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike, Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ka një staf prej 8 pedagogësh, nga të cilët 5 pedagogë me kohë të plotë dhe 3 me kohë të pjesshme. Të gjithë pedagogët e angazhuar zotërojnë minimalisht gradën “Doktor”, ndërsa nga stafi akademik me kohë të plotë 1 pedagog ka titullin “Profesor” dhe nga stafi akademik me kohë të pjesshme 2 pedagogë kanë titullin “Profesor”.

Tabela format për vlerësimin e jashtëm të programeve të studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike mbështetur në Standardet shtetërore për programet e studimit të Ciklit të Dytë	
Standardet/kriteret	Mendimi i GVJ për përmbushjen e standardit/kriterit¹
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike janë të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Kreditet që duhet të plotësohen për të përfunduar me sukses programin Master Profesional (MND) janë 60 ECTS , ndërsa për Master Shkencor (DND) janë 120 ECTS .
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Kohëzgjatja për programin MND Inxhinieri Kompjuterike është 1 vit, ndërsa për programin DND Inxhinieri Kompjuterike është 2 vjet, duke realizuar në këtë mënyrë 60 kredite ECTS në vit .
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Misioni i Universitetit Epoka është transformimi në një institucion mësimor-kërkimor me influencë e inovativ, në shërbim të vlerave humane thelbësore nëpërmjet prodhimit, shpërndarjes dhe kontributit me njohuri në nivel ndërkombëtar; rritja e individëve me ndjeshmëri sociale, të mirëkualifikuar, produktivë, profesionalë dhe të përgjegjshëm, me shpirt të orientuar drejt kërkimit, të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare; si dhe dhënia e kontributit në kuadër të përmirësimit të cilësisë së jetës së shoqërisë bazuar në nevojat rajonale dhe botërore. Programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike janë në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit Epoka.
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike kanë për qëllim formimin e të diplomuarve me baza të mjaftueshme teorike dhe me bagazh shumë të mirë praktik për integrimin në tregun e punës në fushën e Inxhinierisë së Kompjuterave.
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	Në strategjinë e zhvillimit të vendit një rol i veçantë i dedikohet teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit. Konsiderohet se inxhinieria e

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrimpër të gjitha kriteret. Në fund të kriterëve duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

	kompjuterave është sot një nga degët kryesore të inxhinierisë që kontribon përmes shërbimeve profesionale në zhvillimin më të mirë e të qëndrueshëm të shoqërisë. Në këtë aspekt programet e propozuara të studimeve kontribojnë fuqishëm në përgatitjen e inxhinierëve të kualifikuar të cilët do të mbështesin zhvillimet e shpejta të teknologjië së informacionit në dekadat e fundit dhe prioritetet kombëtare në këtë drejtim.
Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	Programet e propozuara të studimeve, megjithëse nuk ka të bëjë direkt me fushën e ruajtjes së vlerave kombëtare, mbështetin zhvillimet prioritare të kohës në Shqipëri e më gjerë.
Konkluzione: Programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike janë në përputhje me misionin dhe qëllimet e Universitetit Epoka, kanë për qëllim formimin e të diplomuarve me baza të mira teorike dhe me bagazh praktik për integrimin në tregun e punës në fushën e Inxhinierisë së Kompjuterave.	
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit	Qëllimet strategjike të Universitetit Epoka janë konceptuar duke u mbështetur në individualitetin institucional të universitetit si dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë 2008-2013 të Republikës së Shqipërisë, strategjitë e përcaktuara nga Fondacioni European mbi Menaxhimin e Cilësisë si dhe strategjitë e miratuara nga Bordi i Vlerësimit të Arsimit të Lartë të Republikës së Turqisë. Programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të këtij universiteti.
Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;	Plani dhe programet mësimore janë të tilla që synojnë paisjen e studentëve me njohuri të thelluara teorike e trajnim për kërkimin shkencor (në rastin e DND në Inxhinieri Kompjuterike) dhe njohuri praktike e trajnim të mirëfilltë profesional (në rastin e MND Inxhinieri Kompjuterike).
Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;	Programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike bazohen kryesisht në studimet Bachelor të të njejtit profil të Universitetit Epoka duke synuar në thellimin e njohurive dhe orientimin si për tregun e punës ashtu edhe për botën akademike.

Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;	-
Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;	Programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike janë konceptuar mbi bazën e eksperiencave më të mira si të vendit ashtu edhe ndërkombëtare, duke synuar paisjen e tyre me kompetenca të përgjithshme e profesionale me mundësi punësimi në kompani të tilla si: banka, industri ajrore, departamente qeveritare, kompani konsultimi dhe organizata që punojnë me sisteme kompjuterike të mëdha si dhe firma të specializuara në sektorin e paisjeve kompjuterike.
Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;	Universiteti Epoka me strukturat dhe infrastrukturën mësimore siguron një lidhje shumë të mirë midis mësimdhënies dhe kërkimit, çka është edhe një ndër kërkesat bazë që duhet të përmbushin institucionet që ofrojnë programe mësimore të të dy cikleve e që synojnë të angazhohen edhe në ciklin e tretë. Këtij qëllimi i shërben edhe rritja e shtrirjes së kërkimit shkencor në programin e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike, në mënyrë të veçantë duke i dhënë një peshë të konsiderueshme kërkimit të manifestuar nëpërmjet punimit të diplomës, i cili synohet të konceptohet si një punim i mirëfillt shkencor.
Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	Programi i studimit MND në Inxhinieri Kompjuterike është konceptuar si një program me objektiva dinamike profesionale. Për këtë qëllim plani mësimor është konceptuar mbi bazën e lëndëve me zgjedhje me të cilat synohet një orientim më fleksibël drej nevojave specifike të tregut. <i>Megjithatë jemi të mendimit që një bërthamë e lëndëve të përcaktuara paraprakisht në planin mësimor do të orientonte më mirë studentët drej lëndëve me zgjedhje.</i>
Konkluzione: Programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe mbështeten në eksperiencat më të mira si të vendit ashtu edhe të huaja në përgatitjen e specialistëve në fushën e inxhinierisë së kompjuterave me mundësi të shumta punësimi si brenda ashtu edhe jashtë vendit.	

Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;	Programet e studimit, të miratuara dhe në proces zbatimi, u përgjigjen kërkesave të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" (<i>posaçërisht neneve 25, 26, 27, 28, 29 dhe 30 të këtij ligji</i>), si dhe kërkesave të Udhëzimit të MASH Nr.15 datë 04.04.2008 (<i>posaçërisht kërkesat VII, VIII dhe IX të tij</i>). Gjithashtu, gjykojmë se ato respektojnë standardet dhe kërkesat e Marrëveshjes së Bolonjës dhe reflektojnë zhvillimet dhe kërkesat aktuale e perspektive të tregut të punës në dimensione kombëtare, rajonale e ndërkombëtare.
Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.	Emërtimet e programeve të studimeve DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike janë në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Me ndryshimet në Ligjin e Arsimin të Lartë, këto emërtime kanë ndryshuar respektivisht në Master Shkencor dhe Master Professional në Inxhinieri Kompjuterike.

Konkluzione:

Programet e studimeve DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike (të përshtatura në vijim në Master Shkencor dhe Master Professional në Inxhinieri Kompjuterike) ofrohen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;	Programi i studimeve DND Inxhinieri Kompjuterike është konceptuar për t'ju përgjigjur kërkesave për punonjës shkencorë dhe inxhinierë të specializuar në fushën e kompjuterave për industrinë dhe botën akademike, ndërsa programi i studimeve MND Inxhinieri Kompjuterike nëpërmjet një plani mësimor fleksibël ofron një larmi formimesh të specializuara në përputhje me kërkesat e tregut.
Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.	Vlerësimi sasior i studentëve bëhet në bazë të sistemit amerikan të krediteve dhe ECTS-së. Procesi mësimor përbëhet nga leksionet, projektet, punimet në laborator, praktikat, seminare dhe punime të tjera të ngjashme, të parashikuara në programin mësimor. Forma e kontrollit të dijes bëhet përmes sistemit të vlerësimit me elemente të shumfishtë.

Konkluzione:

Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve, nëpërmjet formave të larmishme si të mësimdhënies ashtu edhe të kontrollit, duke i dhënë peshën e duhur kontrollit të vazhdueshëm.

Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disaveçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane	Programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike reflektojnë zhvillimet dhe kërkesat aktuale e perspektive të tregut të punës në dimensione kombëtare, rajonale e ndërkombëtare dhe janë hartuar mbi
---	---

	bazën e përvojës amerikane (tashme e provuar si mjaft e suksesshme) duke u përshtatur me sistemin mësimor evropian. Përgatitja e kurrikulave është bërë me konsultimin dhe kontributin e stafit si me kohë të plotë, dhe atij me kohë të pjesshme, bazuar në përvojat e tyre të mëparshme.
Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në to metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;	Edhe pse programet e studimeve janë bazuar në sistemin amerikan të arsimit të lartë, janë adoptuar në të njëjtën kohë edhe kreditet ECTS, të cilat përbëjnë një element kyç në procesin e Bolonjës. Gjithashtu, arsimi në gjuhën angleze në lehtëson lëvizjen e studentëve të universitetit në kuadër të EHEA-së, si dhe atë të studentëve të huaj drejt programeve të studimit të Universitetit Epoka.
Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.	Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. Kjo kontribon jo vetëm në "lexueshmërinë" e programeve të studimit, por edhe në mundësinë e transferimit të krediteve e niveleve të studimit për në dhe nga universitete të tjera në Europë e më gjerë.
Konkluzione: Programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike kanë dimensione ndërkombëtare. Kontribut të veçantë për këtë ka jo vetëm sistemi amerikan që është marrë për bazë në ndërtimin e tyre, por edhe përshtatja me sistemin mësimor evropian. Një element mjaft pozitiv në këtë drejtim përbën edhe zhvillimi i mësimin në gjuhën angleze. Nga RVB del qartë se Universiteti Epoka është i angazhuar në zhvillimin e një bashkepunimi të gjithanshëm me institucione të arsimit të lartë si brenda vendit ashtu edhe jashtë vendit me qëllim të shkëmbimit të eksperiencave më të mira në drejtim të formimit të studenteve dhe kërkimit shkencor në kuadrin e realizimit të misionit të tij institucional.	
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;	Në programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike shtjellohen, në mënyrë të shkallëzuar, parashikimet për njohuritë e fituara, për aftësitë e përgjithshme për të vepruar, aftësitë për të vepruar në fusha të veçanta, për aftësitë për punë kërkimore-shkencore, dhe aftësitë për të komunikuar. Për secilin prej këtyre shkallëve të njohurive dhe aftësive të fituara, përshkruhen metodat dhe instrumentet kryesore që do të përdoren, si dhe elementët kryesorë të procesit të vlerësimit. <i>Jemi të mendimit se shtjellimi i kujdesshëm që i është bërë këtij dimensionin në gjithë programet e studimit, përfaqëson në vetvete një përvojë pozitive të njësisë, që mund t'u shërbejë edhe njësive të tjera të arsimit të lartë, publike apo private.</i>

Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;	Programet e studimeve DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike janë hartuar në përputhje me profilin e Universitetit Epoka dhe strategjinë e tij për zhvillim.
Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;	Asistenca për kërkimet shkencore, mbështetja për pjesmarrje në takimet shkencore dhe stimulimi i publikimeve shkencore janë tre zëra me rritje të qëndrueshme në buxhetin e Universitetit Epoka.
Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.	RVB tregon se Universiteti Epoka inkurajon aktivitetet kërkimore shkencore. Të gjitha politikat lidhur me kërkimin shkencor janë të rregulluara në Direktivën e “Inkurajimit të Kërkimeve Shkencore në Universitetin Epoka”. Duhet theksuar se gjithë stafi akademik është i motivuar për kërkimin shkencor dhe kjo për vetë klauzolat e kontratës së punësimit.
Konkluzione: Mbështetja e procesit mësimor nga një veprimtari kërkimore në rritje kontribon në rritjen e cilësisë së përgatitjes së studenteve dhe në zhvillimin e kapaciteteve të tyre inovative. Funksionimi i laboratorëve mundëson që një pjesë e ligjëratave, të mbahen në laboratorët përkatës, duke përdorur pajisjet e nevojshme. Kështu, duke përfituar nga mundësitë e aplikimit të ofruara nga këta laboratorë, lektorët përkatës mund të integrojnë lehtësisht rezultatet e kërkimit shkencor me procesin mësimdhënës.	
Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Misioni i programit të studimit është formimi i të diplomuarve të këtij cikli me baza teorike dhe me një bagazh të mirë praktik për integrimin në tregun e punës në fushën e inxhinierisë së kompjuterave. Megjithatë nuk ka ndonjë studim real tregu, institucioni bazohet në zhvillimet e shpejta të teknologjisë së informacionit në dekadat e fundit dhe prioritetet kombëtare në këtë drejtim.
Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.	Konsiderohet se inxhinieria e kompjuterave është sot një nga degët kryesore të inxhinierisë që kontribon përmes shërbimeve profesionale në zhvillimin më të mirë e të qëndrueshëm të shoqërisë.
Konkluzione: Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së informacionit bën që inxhinieria e kompjuterave të jetë sot një nga degët kryesore të inxhinierisë për të cilën tregu i punës, jo vetëm brenda vendit, por edhe në rajon e më gjerë ka kërkesa në rritje.	
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;	Programet e studimeve DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike marrin parasysh kërkesat në rritje për specialistë në fushën e teknologjisë së informacionit duke ofruar një larmi formimesh të specializuara në këtë fushë dhe përputhen me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.

Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin: - mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar; - kërkesat e punëdhënësve; - një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; - numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.	Që nga themelimi i Universitetit Epoka, i është vënë rëndësi zbatimit të procesit të mësimdhënies, që do t'u mundësojë studentëve të krijojnë lidhje me kërkesat e tregut vendas të punës, duke filluar nga studimet e tyre universitare. Në këtë drejtim, rëndësi e veçantë i është dhënë organizimit të praktikave për studentët në institucione të ndryshme publike, si dhe në kompani private si brenda dhe jashtë Shqipërisë, kryesisht gjatë sezonit të verës. Tregu i punës është gjithmonë në kërkim të kandidatëve që kanë cilësi dhe përvoja shtesë për pozicionet e punës që ata ofrojnë. Një pjesë e konsiderueshme e studentëve të angazhuar në praktikat profesionale i zhvillojnë ato jashtë Shqipërisë duke u kompletuar edhe me një eksperiencë ndërkombëtare në fushat përkatëse.
Konkluzione: Programet e studimit marin parasysh kërkesat në rritje për specialistë në fushën e teknologjisë së informacionit duke ofruar një larmi formimesh të specializuara në këtë fushë dhe përputhen me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar. Mësimdhënia në gjuhën angleze lehtëson mjaft komunikimin dhe shkëmbimet me universitete të tjera jashtë Shqipërisë, duke mundësuar formimin e studentëve jo vetëm për tregun kombëtar, por edhe atë rajonal e më gjerë.	
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtar;	Programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike, jo vetëm që nuk bien ndesh me interesat kombëtare, por kontribuojnë direkt në përgatitjen e inxhinierëve të cilët me kompetencat e tyre, do të punojnë për realizimin e objektivit strategjik: Shqipëria - vend i zhvilluar.
Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.	Si programe studimi në fushën e teknologjisë së informacionit, programet e mësipërme, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese kompjuterike, zhvillimit të bazave të të dhënave, zhvillimit të rrjeteve kompjuterike etj., do të kontribuojnë indirekt edhe në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.
Konkluzione: Programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike, kontribuojnë direkt në përgatitjen e inxhinierëve të cilët me kompetencat e tyre të thelluara, do të punojnë për realizimin e objektivit strategjik: Shqipëria - vend i zhvilluar.	
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	Plani Mësimor në Universitetin Epoka përbën dokumentacionin kryesor me karakter të gjerë informativ, ku parashtrohet në mënyrë të sintetizuar emërtimi i programit të studimit, objektivat formuese, kohëzgjatja normale e studimeve; tërësia e veprimtarive formuese (disiplinave) që përbëjnë programin e studimit të

	grupuara nëpër semestra dhe të renditura sipas semestrave; kreditet për çdo veprimtari formuese, shpërndarjen e krediteve brenda një disipline sipas aktiviteteve formuese të saj; karakteristikat e tezës së diplomës. Plani mësimor është objekt rishikimi dhe vlerësimi periodik.
Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;	Sipas raportit të vetëvlerësimit, në Universitetin Epoka sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë është ngritur dhe ka funksionuar me të gjitha strukturat në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë. Kështu në nivel njësie bazë siç është departamenti analizohen programet mësimore, literatura, sistemet e vlerësimit para çdo fillimi të vitit të ri akademik dhe në vazhdim të tij. Nga ana e GVJ u konstatua se në fakultet janë institucionalizuar elementë të sistemit të sigurimit të cilësisë, është ngritur dhe funksionon një sistem i plotë i dokumentuar që të garantojë sigurimin e cilësisë në të gjitha aktivitetet e tij, në përputhje me standardet përkatëse.
Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;	Rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrihen publikohen në trajtën e Raportit të vetëvlerësimit.
Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta: <u>Të tërthorta:</u> - Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; - Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; - Pyetje konceptuale; - Intervista; - Etj. <u>Të drejtpërdrejta:</u> - Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj.); - Dëgjime në auditor; - Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; - Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; - Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);	Sipas RVB, në kuadrin e krijimit të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë në Universitet, duke filluar nga semestri i vjeshtës së vitit akademik 2008-2009, e gjithë puna e stafit akademik është vlerësuar nga ana e studentëve në fund të çdo semestri përmes plotësimit të një ankete të përbërë nga kategori të veçanta për vlerësimin e pedagogut, vlerësimin e lëndës, si dhe kënaqësinë e përgjithshme të studentëve përsa i përket çdo lënde të dhënë nga pedagogu përkatës. Studentët mund të shprehin kënaqësinë ose pakënaqësinë e tyre në lidhje me kategoritë përkatëse duke ruajtur konfidencialitetin e plotë. Përgjigjet e marra nga studentët janë analizuar dhe janë marrë gjithashtu edhe rezultatet përkatëse. Rezultatet e performancës janë shpërndarë nga Rektori për instruktorët në fjalë, si dhe për krerët e departamenteve përkatëse. Fshehtësia e këtij informacioni është e mbrojtur në të gjitha fazat e nxjerrjes së rezultateve, shpërndarja e korrespondencës në njësitë në fjalë, personat, si dhe në arkivimin e korrespondencës. Rezultatet e anketave të vlerësimit të pedagogëve dhe të lëndës sigurojnë të dhëna sasiore të rëndësishme që janë marrë në konsideratë në lidhje me rinovimin e kontratave me stafin akademik, si dhe në caktimin e këtij personeli në lëndët përkatëse. Në rregulloren e studimeve një vëmendje e veçantë i kushtohet kontrollit të dijeve të studentëve. Forma e vlerësimit të dijeve të studentëve për çdo lëndë është e përcaktuar në

f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; h. Etj.	syllabuset e programit të studimit, ku në një masë të konsiderueshme të vlerësimit përfundimtar (pothuajse 50%) e zë vlerësimi që merr studenti për elementët e lëndës përkatëse si dhe vlerësimet e marra në kontrollet e ndërmjetme. Në arkivën e departamenteve ruhen për një kohë të përcaktuar të gjitha kontrollet e kryera të studentit, procesverbalet e mbajtura nga ana e pedagogëve në lidhje me vlerësimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare të studentit duke siguruar një gjurmueshmëri të qëndrueshme në të gjitha hallkat e mekanizmit të vlerësimit të ngritur, për të eliminuar çdo lloj inflacioni institucional të notës. Së fundi, GVJ dëshiron të vërë në dukje se nga bisedat me drejtuesit e departamenteve, fakulteteve dhe me stafin akademik në tërësi, u evidentua vetë-dijësimi institucional për nevojën e përpunimit të vazhduar të proceseve të garantimit të cilësisë. Prania e një kulture institucionale të vlerësimit kritik të vetvetes nëpërmjet organizimit të vlerësimeve të brendshme dhe planifikimit të përmirësimeve të nevojshme, që GVJ e gjeti të shprehur në prova dokumentare, janë garanci për qasjen objektive të institucionit ndaj menaxhimit të cilësisë tani e në të ardhmen.
Konkluzione: Në Universitetin Epoka sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë është ngritur dhe ka funksionuar me të gjitha strukturat në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë. Kështu në nivel njësie bazë siç është departamenti analizohen programet mësimore, literatura, sistemet e vlerësimit para çdo fillimi të vitit të ri akademik dhe në vazhdim të tij. Në fakultet janë institucionalizuar elementë të sistemit të sigurimit të cilësisë, është ngritur dhe funksionon një sistem i plotë i dokumentuar që të garantojë sigurimin e cilësisë në të gjitha aktivitetet e tij, në përputhje me standardet përkatëse.	
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	
Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;	Sikurse përcaktohet edhe në statut, programet dhe planet mësimore janë objekt diskutimesh e përmirësimesh të vazhdueshme, dhe u janë nënshtruar rishikimeve, në përputhje jo vetëm me kërkesat e akteve të reja nënligjore, por edhe duke reflektuar sugjerime që vijnë nga stafi akademik, studentët, apo institucionet me të cilat bashkëpunohet.
Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	Nga raporti i vetëvlerësimit bëhet e qartë se Universiteti Epoka synon në arritjen dhe mbajtjen e standarteve të larta akademike në përputhje me misionin e Universitetit. Elementë kyç të këtyre parimeve përfshijnë qartësinë dhe saktësinë e përcaktimit dhe komunikimit të standardeve akademike të Universitetit Epoka, nëpërmjet proceseve të tilla si politikat e pranimi të studentëve, përcaktimi i kërkesave të qarta për rekrutimin e stafit akademik, për mbështetjen e tij me programe kualifikuese, përdorimin e metodave

	të larmishme të mësimdhënies, proceset gjithëvjetoze dhe shumëplanëshe të vlerësimit të balancuar, sistemeve të administrimit të dokumenteve, etj.
Konkluzione: Ka një përpjekje konstante për përmirësimin e programeve të studimeve në përputhje jo vetëm me kërkesat e akteve të reja nënligjore, por edhe duke reflektuar sugjerime që vijnë nga stafi akademik, studentët, apo institucionet me të cilat bashkëpunohet.	
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	
Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;	Programet i studimit DND Inxhinieri Kompjuterike realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30 kredite europiane ECTS për tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja e këtij program studimi është 2 vite akademike (4 semestra).
Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.	Programi i studimit MND Inxhinieri Kompjuterike realizohet me 60 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja e tij është një vit akademik.
Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).	-
Konkluzione: Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike të Universitetit Epoka janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	
Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.	
Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;	Universiteti Epoka boton rregullisht informacion rreth programeve të ofruara, pritshmëritë e rezultateve të tyre, kualifikimet e marra, mësimdhënien, të mësuarit dhe procedurat e vlerësimit të përdorura, si dhe mundësitë e nxënies në dispozicion të studentëve. Një element i rëndësishëm në drejtim të garantimit të cilësisë është funksionimi i Këshillit të Vlerësimit Akademik dhe Përmirësimit të Cilësisë . Ky këshill, i cili drejtohet nga Rektori dhe përbëhet nga të paktën një Zv/Rektor, dekanet e fakulteteve, kancelari, përgjegjësi i sekretarisë mësimore, një ekspert i huaj dhe një përfaqësues nga organizma studentore, ka përgjegjësi për të siguruar cilësinë e brendshme të Universitetit Epoka.

Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj., për vlerësimin e brendshëm.	Universiteti Epoka ka instaluar programin e automatizimit, përbërë nga Sistemi i Informacionit i Sekretarisë Mësimore (SISM) që është një sistem interaktiv ku studentët dhe stafi mund të kryejnë pjesën më të madhe të procedurave me anë të kompjuterëve. Faqja SISM mund të arrihet në https://sais.epoka.edu.al. Nga faqja hyrëse, duke përdorur Student ID (ose emrin) dhe fjalëkalimin, studentët dhe personeli mund të hyjnë në faqen e tyre SISM. Faqja SISM përfshin informacionin e mëposhtëm në lidhje me informacione kredenciale, mesazhe, regjistrimin, kurse, etj. Në të njëjtën kohë, programi i automatizimit të Universitetit Epoka përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët, stafin dhe infrastrukturën fizike të Universitetit.
Konkluzione: Universiteti Epoka publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm. Një rol të veçantë në këtë drejtim luan Sistemi i Informacionit i cili siguron një komunikim cilësor me studentin dhe ofron një transparencë të rritur. Prania e një kulture institucionale të vlerësimit kritik të vetvetes nëpërmjet organizimit të vlerësimeve të brendshme dhe planifikimit të përmirësimeve të nevojshme, që GVJ e gjeti të shprehur në prova dokumentare, janë garanci për qasjen objektive të institucionit ndaj menaxhimit të cilësisë tani e në të ardhmen.	
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I INSTITUCIONIT BËHET NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE.	
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit është i angazhuar në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre.
Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit është i angazhuar në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.
Konkluzione: Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ janë të angazhuar për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike.	
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	Nga shqyrtimi i dokumentacionit themelor të Universitetit Epoka, del e qartë se strategjia e tij është përqendruar në tre drejtime kryesore: mësimdhënia, kërkimi shkencor dhe kontributi për shoqërinë. Misioni i Universitetit Epoka është transformimi në një institucion mësimor-kërkimor me influencë e inovativ, në shërbim të vlerave humane thelbësore

	nëpërmjet prodhimit, shpërndarjes dhe kontributit me njohuri në nivel ndërkombëtar; përgatitja e individëve me ndjeshmëri sociale, të mirëkualifikuar, produktivë, profesionalë dhe të përgjegjshëm, me shpirt të orientuar drejt kërkimit, të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare; si dhe dhënia e kontributit në kuadër të përmirësimit të cilësisë së jetës së shoqërisë bazuar në nevojat rajonale dhe botërore. Universiteti Epoka është i organizuar dhe operon si një Institucion i Arsimit të Lartë i cili ofron programe studimi të nivelit të parë, të dytë dhe të tretë në funksion të misionit të tij.
Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;	Universiteti ka filluar procesin mësimor në vitin 2007 me dy fakultete: Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë dhe Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Administrative.
Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;	Çdo fakultet ka 3 deri në 4 njësi bazë (departamente) nga 3 të kërkuara minimalisht nga ligji. Në shërbim të tyre janë edhe Qendrat Kërkimore të cilat garantojnë mësimdhënien nëpërmjet kërkimit shkencor dhe shërbejnë për të nxitur pjesëmarrjen në kërkim shkencor si të stafit akademik të Universitetit Epoka ashtu edhe të studentëve.
Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;	Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë <i>përbëhet nga 3 departamente:</i> • Departamenti i Arkitekturës • Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit • Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike Misioni i Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike është që të edukojë studentët me njohuritë bazë të shkencës dhe teknikës në mënyrë që ata të mund të zhvillojnë zgjidhje për problemet e inxhinierisë kompjuterike si dhe për të rritur aftësitë e tyre në shkencat kompjuterike, arkitekturës së kompjuterit, dizajnit dhe analizës së algoritmeve, programimit të softwareve, komunikimit dhe aftësive hulumtuese. Departamenti ka për qëllim të inkurajojë sidomos punën në grup, punën e pavarur dhe të menduarit inovativ si dhe cilësitë e drejtuesit.
Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.	Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike që mbulon programet e studimit në DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike përbëhet nga: • 4 pedagogë me kohë të plotë me gradën shkencore “Doktor” • 4 pedagogë me kohë të pjesshme me gradën shkencore “Doktor” • 6 pedagogë me kohë të plotë me gradën shkencore “Master i Shkencave” • 2 pedagogë me kohë të plotë me gradën shkencore “Master i Shkencave”

	1 asistent kërkimor Personeli akademik i angazhuar në programet e studimit të ciklit të dytë ka minimalisht gradën shkencore “Doktor”.
Konkluzione: Universiteti Epoka në përgjithësi si dhe strukturat përgjegjëse për organizimin e programeve të studimeve DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore të Republikës së Shqipërisë në funksion të përmbushjes së misionit.	
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;	Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike që mbulon programet e studimit në DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike është i angazhuar plotësisht për realizimin e tyre.
Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.	Procesi i rekrutimit të stafit menaxhohet nga Këshilli i Administrimit të Universitetit, i cili shpall vendet e lira, llojin e vendit të lirë (me kohë të plotë ose të pjesshme), si dhe të gjitha karakteristikat dhe kushtet e tjera të nevojshme që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për një vend të lirë pune, në të cilin kërkohet titulli Doktor, Docent, Profesor i Asociuar dhe Profesor. Kohëzgjatja e shpalljes së vendit të lirë është të paktën 15 ditë. Në të njëjtën kohë, procedurat dhe data e mbylljes së aplikimeve shpallen në mënyrë të qartë. Për vlerësimin e aktiviteteve akademike të kandidatëve përdoret një sistem pikëzimi i cili përfshin aktivitetet botuese, aktivitetin mësimor projektet kërkimore etj.
Konkluzione: Realizimi i programeve të studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike është përgjegjësi direkte e departamentit Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, i cili bën koordinimin e punës për mbulimin e plotë të aktiviteteve të parashikuara në secilin program si dhe vlerësimin e aktivitetit të punonjësve akademikë.	
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;	Kurrikulat janë përgatitur sipas sistemit mësimor amerikan dhe atij europian. Përgatitja e kurikulave është bërë me konsultimin dhe kontributin e stafit si me kohë të plotë ashtu dhe atij me kohë të pjesshme, bazuar në përvojat e tyre të mëparshme.
Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.	Në Universitetin Epoka ka kriteret e qarta për aplikimin për vende të lira të punës, punësimin dhe vlerësimin e performancës së stafit akademik, duke marrë në konsideratë punimet shkencore të kandidatëve dhe eksperiencën në punë si dhe duke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Gjithë aktiviteti akademik i kandidatëve vlerësohet me një sistem pikësimi ku merren parasysh, artikujt, prezantimet, librat, përkthimet, redaktimi dhe arbitrimi, referencat, aktiviteti mësimor,

	këshillimi për tezat, projekte kërkimore të përfunduara, çmime të ndryshme, detyra administrative etj. Edhe për marrjen në punë, ngarkesën mësimore, cilësinë dhe kontrollin e kandidatëve për staf ndihmës ka kritere të përcaktuara qartë. Kandidati për staf ndihmës (asistent kërkimor) duhet të jetë i diplomuar të paktën nga një program Master (Diplomë e Nivelit të Dytë ose Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë.) Emërimi i stafit ndihmës bëhet mbas kërkesës me shkrim të departamenteve përkatëse, vendimit të Këshillit Administrativ të Fakultetit përkatës, propozimit të Rektorit drejtuar Këshillit të Lartë të Universitetit dhe miratimit nga ana e këtij të fundit. Ngarkesa e punës është rregulluar në kontratën e punës së tij me Universitetin në përputhje me ligjet, rregulloret dhe udhëzimet e Republikës së Shqipërisë.
Konkluzione: Në Universitetin Epoka ka kritere të qarta për aplikimin për vende të lira të punës, punësimin dhe vlerësimin e performancës së stafit akademik, duke marrë në konsideratë punimet shkencore të kandidatëve dhe eksperiencën në punë si dhe duke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e planeve mësimore në përputhje me politikat e zhvillimit të institucionit	
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	Universiteti Epoka ka filluar procesin mësimor në vitin 2007 me dy fakultete: Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë dhe Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Administrative.
Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;	Universiteti Epoka për vitin akademik 2010-2011 është zhvendosur kryesisht në ambientet e reja të kampusit universitar që ka filluar të ndërtohet në vitin 2009. Ka hyrë në funksionim ndërtesa e parë në kampus, e cila përfshin ambiente mësimdhënieje, zyra moderne si dhe një kafeteri dhe mensë (sipërfaqe e brendshme prej rreth 6200m²). Ndërkohë, ndërtimi i ndërtesave të tjera pritet të materializohet në disa faza brenda një periudhe afatshkurtër.
Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;	Objektet e Universitetit Epoka janë konstruktuar në një mënyrë bashkëkohore me materiale cilësore, duke plotësuar kushtet higjienosanitare për studentët, personelin akademik dhe administrativ. Materialet e përdorura nuk përmbajnë elementë të rrezikshëm për shëndetin dhe akustika e mjediseve është e përshtatshme për procesin mësimor. Në ambientet e Fakulteteve ka salla të mëdha leksionesh, salla për seminarët, zyra të pajisuara shumë mirë për punonjësit akademikë, për punonjësit ndihmës dhe mbështetës, salla për

	kompjuterat, ku ofrohet shërbimi i internetit për studentët dhe për stafin akademik, bibliotekë dhe sallë leximi, etj.
Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.	Përveç shfrytëzimit të laboratorëve dhe kapaciteteve të qendrave kërkimore të vetë institucionit, rëndësi e veçantë i është dhënë organizimit të praktikave për studentët në institucione të ndryshme publike, si dhe në kompani private si brenda dhe jashtë Shqipërisë, kryesisht gjatë sezonit të verës.
Konkluzione: Konstatimi GJV është se mjediset aktuale janë moderne dhe me hapësira funksionale për zhvillimin e të gjitha veprimtarive universitare. Po ashtu zhvillimi perspektiv i infrastrukturës ndërtimore synon ta shndërrojë Universitetin Epoka në një pol të zhvillimit të dijes. Infrastruktura ndërtimore mbështetet nga një infrastrukturë moderne laboratorike e shërbimesh si dhe nga një infrastrukturë njerëzore cilësore dhe të përkushtuar. Kjo infrastrukturë përfshin politikat e rekrutimit të stafit dhe ato të zhvillimit profesional. Këto shërbime përfshijnë: shërbimet IT, Bibliotekën, shërbimet për studentët, mbështetjen me tutor, Qendrën e Formimit të Vazhduar dhe Planifikimit të Karrierës, etj.	
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;	Në Universitetin Epoka, infrastruktura teknologjike dhe teknologjitë e informacionit përdoren në nivelin më të lartë. Universiteti Epoka disponon një sistem informacioni - Information Systems Center (ISC) i cili është funksional që prej vitit 2009.
Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Në ditët e sotme, është në dispozicion një sistem qendror kompjuterik i zgjeruar. Sistemi i shërben mësimin, dhe kërkimit shkencor, duke plotësuar nevojat në nivel shumë të mirë. Kompjuterët në dispozicion të studenteve përmbajnë parametrat e duhur për një përdorim të programeve më të specializuara profesionale, dhe me një cilësi mjaft të mirë. Secili nga studentet pajiset me “user-name” dhe “pass-word” personal, që lejon hyrjen në sistemin e dokumenteve personale për secilin dhe mund të gjejnë aty dokumentet e tyre individuale. Zyra e IT e Universitetit Epoka ka krijuar një arkivë elektronike përveç asaj fizike ekzistuese. Kjo gjë bën të mundur garantimin e një marrëdhënieje akoma me interaktive midis pedagogeve që depozitojnë materialet për studentët (leksione) dhe studentëve të cilët tërheqin në çdo kohë këto materiale si dhe depozitojnë detyrat e tyre të kursit apo materiale të tjera të përgatitura prej tyre.
Konkluzione: Universiteti Epoka siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve nëpërmjet një sistemi informacioni modern.	
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecursisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të	Një element i rëndësishëm në drejtim të garantimit të cilësisë është funksionimi i <i>Këshillit të Vlerësimit Akademik dhe Përmirësimit të Cilësisë</i> . Ky këshill, i

studimeve të ciklit të dytë;	cili drejtohet nga Rektori dhe përbëhet nga të paktën një Zv/Rektor, dekanet e fakulteteve, kancelari, përgjegjësi i sekretarisë mësimore, një ekspert i huaj dhe një përfaqësues nga organizma studentore, ka përgjegjësi për të siguruar cilësinë e brendshme të Universitetit Epoka.
Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	Në përmirësimin e programeve të studimit kontribuojnë edhe dy qendra të Universitetit Epoka: <u>1. Qendra e Kërkimit dhe Aplikimit mbi Menaxhimin e Cilësisë:</u> ka si objektiva ndjekjen e çdo zhvillimi në fushën e arsimit të lartë, analizën e ndikimit të dinamikave të jashtme në dinamikën e brendshme të institucionit si dhe raportimi i rezultateve; planifikimin dhe zbatimin e projekteve të kërkimit dhe aplikimit mbi cilësinë dhe akreditimin; Planifikimi, zbatimin, vlerësimin dhe menaxhimin e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare mbi cilësinë dhe akreditimin; organizimin e seminareve trajnuese kombëtare dhe ndërkombëtare mbi cilësinë dhe akreditimin; sigurimin e përhapjes në Universitet të parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të menaxhimit total të cilësisë; ngritja e bazave të të dhënave, bibliotekave dhe qendrave të dokumentimit brenda dhe jashtë vendit si dhe kryerja dhe mbështetja e publikimeve; matjen dhe vlerësimin e çdo veprimtarie akademike, administrative dhe sociale të institucionit me qëllim informimin e autoriteteve drejtuese të Universitetit, etj. <u>2. Qendra e Formimit të Vazhduar dhe Planifikimit të Karrierës</u> funksionet kryesore të së cilës janë organizimi i seminareve dhe kurseve me qëllim zhvillimin e individit, institucionit ose organizatës; shërbimi i këshillimit në lidhje me transferimin e ideve dhe praktikave të reja tek strukturat dhe individët e institucionit; realizimi i projekteve në fusha të ndryshme të ekspertizës si dhe lehtësimi i procesit të punësimit të të diplomuarve dhe menaxhimi i marrëdhënieve me të diplomuarit nga Universiteti.
Konkluzione: Programet e studimeve në DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme, qoftë nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, qoftë në aspekte më të përgjithshme të orientimit nga <i>Këshillit të Vlerësimit Akademik dhe Përmirësimit të Cilësisë</i> , nga <i>Qendra e Kërkimit dhe Aplikimit mbi Menaxhimin e Cilësisë</i> dhe nga <i>Qendra e Formimit të Vazhduar dhe Planifikimit të Karrierës</i> . Një rëndësi të veçantë merr feedback-ut nga student i cili shërben dhe përvendimmarrje në lidhje me përmirësimin si të metodave të mësimdhënies ashtu edhe të kurrikulave.	
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;	Detajimi i zhvillimit të procesit mësimor shoqërohet me procedura të qarta të vlerësimit të punës së studentëve dhe kufiri minimal i cili lejon studentin të marrë tezën e diplomës. Një kujdes i veçantë i tregohet zhvillimit të

	praktikave dhe stazheve verore duke ofruar mundësinë e zhvillimit të tyre në kompani të rëndësishme e të mirënjohura në Shqipëri si dhe jashtë saj. Të qenurit në gjendje për të pasur një përvojë pune para diplomimit nga universiteti u jep studentëve një avantazh të theksuar në krahasim me ata të diplomuar që nuk e kanë një mundësi të tillë. Ndërkohë, një iniciativë tjetër synon një kalim sa më efektiv të studentëve në prag të diplomimit në jetë profesionale nëpërmjet ndihmës dhe udhëzimeve të Mentorëve të Kualifikuar.
Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	Për realizimin e programit të studimeve në DND Inxhinieri Kompjuterike janë parashikuar 30 kredite për tezën e diplomës, ndërsa për programin MND Inxhinieri Kompjuterike 12 kredite ECTS.
Konkluzione: Zhvillimi i programeve të studimeve në DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike përmbajnë një detajim të zhvillimit të procesit mësimor dhe shoqërohet me procedura të qarta të vlerësimit të punës së studentëve dhe kufiri minimal i cili lejon studentin të marrë tezën e diplomës, duke respektuar kërkesat ligjore për sa i përket projektit kërkimor. Synohet për të pasur një përvojë pune para diplomimit duke u dhënë studentëve një avantazh të theksuar në krahasim me ata të diplomuar që nuk e kanë një mundësi të tillë.	
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Universiteti Epoka disponon dhe menaxhon burimet financiare. Për çdo vit hartohet një raport mbi të ardhurat dhe shpenzimet. Zyra e Financës administron të gjithë informacionin e nevojshëm mbi pagesën dhe çështjet e financiare që i interesojnë stafit dhe studentëve të Universitetit Epoka.
Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Tek të ardhurat vend të veçantë zenë ato që e kanë burimin nga sponsored e ndryshëm (që kanë patur një peshë të madhe në këtë fazë të investimeve të larta fillestare) si dhe nga tarifat e studentëve. Shpenzimet detajohen në mënyrë të tillë ku dallohen elementë si: • Shpenzimet e stafit, • Edukimi, kërkimi dhe zhvillimi, • Shpenzimet për blerjen e të mirave dhe shërbimeve, • Taksta dhe fondet e paguara, • Investimet.
Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	Konstatohet se deri më tani (raporti i fundit ai i 2010-2011) të ardhurat nga tarifat e studentëve kanë qenë më të ulta se shpenzimet e stafit. Vlen të theksohet fakti se shpenzimet për kërkim dhe zhvillim (ku ndër të tjera hyjnë shpenzimet për suportin e kërkimit shkencor, publikimet, blerjet për bibliotekën, bursat etj.) kanë qenë në një shkallë të lartë, minimum 18% e tarifave të studentëve.

Konkluzione:

Universiteti Epoka disponon dhe menaxhon burimet financiare dhe harton një raport vjetor financiar mbi të ardhurat dhe shpenzimet. Konstatohet se deri më tani investimet kanë zënë një peshë të konsiderueshme, duke dëshmuar për përkushtimin e institucionit për ngritjen e një infrastrukture moderne e cila do ti shërbejë zhvillimit perspektiv të Universitetit Epoka. Gjithashtu fakti që shpenzohet në një masë të konsiderueshme për kërkim e zhvillim dëshmon për angazhimin e institucionit për një formim inxhinierik cilësor ku roli i kërkim-zhvillimit të jetë në themel të të mësuarit.

Asistenca për kërkimet shkencore, mbështetja për pjesmarrje në takimet shkencore dhe stimulimi i publikimeve shkencore janë tre zëra me rritje të qëndrueshme në buxhetin e institucionit.

III - PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PËRBËHET NGA PERSONELI AKADEMIK, PERSONELI NDIHMËS MËSIMORSHKENCOR DHE PERSONELI ADMINISTRATIV.

Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.

Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;

Procesi i rekrutimi të stafit menaxhohet nga Këshilli i Administrimit të Universitetit, i cili shpall vendet e lira, llojin e vendit të lirë (me kohë të plotë ose të pjesshme), si dhe të gjitha karakteristikat dhe kushtet e tjera të nevojshme që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për një vend të lirë pune, në të cilin kërkohet titulli Doktor, Docent, Profesor i Asociuar dhe Profesor. Kohëzgjatja e shpalljes së vendit të lirë është të paktën 15 ditë. Në të njëjtën kohë, procedurat dhe data e mbylljes së aplikimeve shpallen në mënyrë të qartë.

Me qëllim vlerësimin e punimeve shkencore të kandidatëve të cilët kanë kaluar vlerësimin paraprak dhe kushtin e gjuhës, Këshilli i Administrimit të Universitetit ngre brenda dy javëve një komision, i cili përbëhet nga tre profesorë të fushës përkatëse. Brenda një muaji, Rektori i dërgon komisionit dosjet e kandidatëve me qëllim vlerësimin të tyre dhe hartimin e raporteve përkatëse. Në rast se për një vend të lirë pune ka më shumë se një kandidat, komisioni përgatit një raport me shkrim për secilin kandidat në të cilin përcakton qartë se cili është kandidati fitues sipas komisionit. Pas marrjes së raporteve me shkrim nga komisioni, Rektori ia përcjell ato Këshillit të Lartë të institucionit. Këshilli i Lartë i Universitetit zgjedh njërin nga kandidatët duke marrë parasysh raportin e paraqitur nga Komisioni, si dhe duke argumentuar zgjedhjen e bërë.

Përt'u emëruar në pozicionin e profesorit me kohë të plotë, përveç kushteve që zbatohen për emërimin e personave në pozicionin e profesorit të asociuar, aplikohen edhe kushtet e mëposhtme:

- a) Të ketë të paktën pesë vjet përvojë pune në fushën përkatëse pas emërimit në pozicionin e profesorit të asociuar (tre nga të cilat duhet të jenë në universitet);

	b) Të ketë punime dhe publikime shkencore të nivelit ndërkombëtar, ndërsa në disiplinat me punë zbatuese, duhet të ketë projekte zbatuese të kryera në praktikë. Përcaktimi i kushteve të kontratës së punës bëhet nga ana e Rektorit me miratimin e Këshillit të Lartë.
Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;	Numri i stafit me kohë të plotë i angazhuar në programet eciklit të dytë të Universitetit Epoka është 30 dhe me kohë të pjesshme 16. Pra përqindja e stafit akademik me kohë të plotë e angazhuar në programet Master është 65.2%, ndërsa e atij me kohë të pjesshme 34.8%. Nga totali prej 46 i stafit akademik të Universitetit Epoka angazhuar në programet Master, 100% e tyre zotërojnë së paku gradën shkencore “Doktor”, ndërkohë që 16 (35%) anëtarë të stafit akademik zotërojnë titullin “Profesor” dhe 3 (7.5%) titullin “Prof.Asoc”. Kjo masë garanton edhe përmbushjen e standarteve që lidhen me kualifikimin shkencor-akademik të stafit.
Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;	GVJ konstatoi një angazhim të përkushtuar në drejtim të ndjekjes së procedurave ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit: • Në mënyre institucionale janë përcaktuar kriteret për vlerësimin e aktiviteteve akademike të personelit akademik dhe të kandidatëve për t’u përfshirë në personel akademik. • Në fakultete është i institucionalizuar procesi i marrjes së feedback-ut nga studenti. Rezultatet e anketave të vlerësimit të pedagogëve dhe të lëndës sigurojnë të dhëna sasiore të rëndësishme që janë marrë në konsideratë në lidhje me rinovimin e kontratave me stafin akademik, si dhe në caktimin e këtij personeli në lëndët përkatëse.
Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.	Problematika e mbajtjes së një baze të dhënash në Universitetin Epoka lidhet me problematikën e menaxhimit të informacionit në këtë institucion, i cili shpërndahet duke përdorur kanalet e mëposhtme: <u>Verbal</u>: Të gjitha zyrat janë përgjegjëse për të dhënë informacion të detajuar mbi Universitetin, aktivitetet e departamenteve, gjithashtu ruajnë integritetin dhe konfidencialitetin e institucionit në çështje specifike. <u>Me shkrim</u>: Informacioni me shkrim lëshohet me kërkesë të personit në fjalë ose për shkak se çështja është e lidhur me studentë të veçantë, anëtarë të stafit akademik ose njësi universitare. <u>Elektronike</u>: Informacioni është i shpërndarë duke përdorur webmail, në këtë kontekst baza e të dhënave e-mail-i është mbajtur e përditësuar. Në mënyrë të veçantë, Zyra e Burimeve Njerëzore

	administron dosjet që përmbajnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të Universitetit Epoka, si dhe menaxhon dhe vazhdimisht përditëson bazën elektronike të të dhënave mbi stafin e Universitetit.
Konkluzione: - Universiteti Epoka ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit. - Janë përcaktuar kriteret për vlerësimin e aktiviteteve akademike të personelit akademik dhe të kandidatëve për t'u përfshirë në personel akademik. - Respektohen kërkesat për raportet staf akademik me kohë të plotë dhe staf akademik me kohë të pjesshme si dhe shkalla e kualifikimit e kërkuar. - Zyra e Burimeve Njerëzore administron dosjet që përmbajnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të Universitetit Epoka, si dhe menaxhon dhe vazhdimisht përditëson bazën elektronike të të dhënave mbi stafin e Universitetit.	
Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.	
Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve përëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;	Përgjegjësi i Departamenti të Inxhinierisë Kompjuterike që mbulon programet e studimit në DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike zotëron gradën “Doktor” të Universitetit Teknik të Stambollit, Turqi dhe “Msc” i universitetit të Chicago, SHBA.
Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;	Zhvillimi i lëndëve/moduleve në programet e studimit në DND Inxhinieri Kompjuterike mbulohet nga një personel akademik i cili minimalisht zotëron gradën shkencore “Doktor”.
Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;	Zhvillimi i lëndëve/moduleve në programet e studimit në MND Inxhinieri Kompjuterike mbulohet nga një personel akademik i cili minimalisht zotëron gradën shkencore “Doktor”.
Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;	Drejtuesit e institucionit, njërive kryesore dhe njërive bazë si dhe përgjegjësi i programit të studimeve janë të punësuar me kohë të plotë në Universitetin Epoka.
Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.	Një kujdes i veçantë i tregohet zhvillimit të praktikave dhe stazheve verore duke ofruar mundësinë e zhvillimit të tyre në kompani të rëndësishme e të mirënjohura në Shqipëri si dhe jashtë saj. Mentorët e Kualifikuar janë individë të zgjedhur nga Universiteti, të cilët vullnetarisht ofrojnë mbështetje profesionale përmes kontakteve e takimeve shoqërore me studentët, të cilët u janë dhënë në ngarkim në bazë të profesionit të tyre. Përgjegjësia kryesore e Mentorit të Kualifikuar është të ndihmojë studentët për të gjetur apo praktikë profesionale gjatë periudhës së verës dhe mundësi punësimi pas diplomimit.

Konkluzione: Personeli akademik i angazhuar për mbulimin e programet e studimit në DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike ka kualifikimin e duhur. Zhvillimi i të gjitha aktiviteteve, përfshirë edhe praktikat profesionale, mbështetet e realizohet kryesisht nga personel akademik dhe ndihmës me kohë të plotë.	
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;	Pedagogët e brendshëm janë të angazhuar në punën shkencore nëpërmjet kërkimit dhe botimeve si : • Botime në Revistat shkencore të universitetit dhe të tjera brenda dhe jashtë vendit ; • Konferencat shkencore, të organizuara nga vetë institucioni dhe nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. • Botime shkencore. Universiteti inkurajon pedagogët e brendshëm të botojnë libra shkencorë. Këto punime janë autentike me kritere akademike të rrepta.
Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Duhet theksuar se gjithë stafi akademik është i motivuar për kërkimin shkencor dhe kjo për vetë klauzolat e kontratës së punësimit. Kërkimi shkencor në Universitetin Epoka zhvillohet kryesisht në kuadrin e qendrave kërkimore, të cilat kanë misionet e objektivat të përcaktuara qartë e mbështeten nga një buxhet kërkimor i konsiderueshëm.
Konkluzione: Universiteti Epoka inkurajon aktivitetet kërkimore shkencore. Të gjitha politikat lidhur me kërkimin shkencor janë të rregulluara në Direktivën e “Inkurajimit të Kërkimeve Shkencore në Universitetin Epoka”. Universiteti Epoka ka një strategji të qartë të zhvillimit të R&D dhe ndjek politika nxitëse për promovimin e Kërkim – Zhvillimit. Kërkimi shkencor në Universitetin Epoka zhvillohet kryesisht në kuadrin e qendrave kërkimore, të cilat kanë misionet e objektivat të përcaktuara qartë e mbështeten nga një buxhet kërkimor i konsiderueshëm.	
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programet e studimit në DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike e zhvillon procesin mësimor në gjuhën angleze. Stafi akademik me kohë të plotë i angazhuar në këto programe studimi është kryesisht i huaj e me njohuri të mira të gjuhës angleze (studime të niveleve të ndryshme të kryera në shkolla të vendeve anglishtfolëse).
Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhën angleze ka përvojë të gjatë të mësimdhënies në këtë gjuhë. Edhe procesi i rekrutimi të personelit të ri akademik kalon nga një vlerësim paraprak i cili ka domosdoshmëri kushtin e gjuhës angleze.

Konkluzione: Programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike zhvillohen në gjuhën angleze dhe personeli akademik, kryesisht i huaj, ka njohuri shumë të mira të kësaj gjuhe duke qenë se në masën dërmuese zotëron diploma të niveleve të ndryshme të fituara në vende anglishtfolëse si dhe ka një eksperiencë të mirë të mësimdhënies në këtë gjuhë.	
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;	Për programin e studimit DND në Inxhinieri Kompjuterike Departamenti i propozon Fakultetit një udhëheqës teze për çdo student në fund të semestrit të parë dhe temën e tezës së përcaktuar nga udhëheqësi i tezës jo më vonë se fundi i semestrit të dytë. Udhëheqësi dhe tema e propozuar vendosen me vendim të Këshillit Administrativ të Fakultetit. Për programin e studimit MND në Inxhinieri Kompjuterike Departamenti i propozon Fakultetit një udhëheqës teze për çdo student në fund të semestrit të parë dhe temën e tezës së përcaktuar nga udhëheqësi i tezës jo më vonë se fundi i semestrit të parë. Udhëheqësi dhe tema e propozuar vendosen me vendim të Këshillit Administrativ të Fakultetit.
Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;	Udhëheqësi i tezës përzgjidhet nga stafi akademik me të paktën gradën “Doktor”. Për programin e studimit DND në Inxhinieri Kompjuterike studenti duhet të regjistrojë tezën në fillim të semestrit të tretë ndërsa për programin e studimit MND në Inxhinieri Kompjuterike studenti duhet të regjistrojë tezën në fillim të semestrit të dytë.
Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.	Duke ju referuar tezave të mbrojtura deri tani, rezulton se një udhëheqës nuk mbikëqyr më shumë se pesë studentë njëkohësisht.
Konkluzione: Sistemi i udhëheqjes së tezave në Universitetin Epoka është i konsoliduar dhe kalon nëpër një procedure mjaft rigoroze. Udhëheqësi i tezës ka të paktën gradën shkencore “Doktor”. Studenti duhet të përgatisë dhe shkruajë tezën në përputhje me rregullat e shkrimit të përpiluara nga Fakulteti dhe të miratuara nga Senati. Universiteti ka kontraktuar për përdorimin e një programi informatik (<i>Turnitin</i>) i cili bën të mundur verifikimin e plagjiaturës gjatë përgatitjes së tezës.	
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	
Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.	Udhëheqësi i tezës përzgjidhet nga stafi akademik i Departamentit me të paktën gradën “Doktor” në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.

Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.	Duke ju referuar veprimtarisë shkencore të anëtarëve të Departamentit të Inxhinierisë së kompjuterave pasqyruar nëpërmjet referimeve e botimeve, mendojmë se garantohet plotësisht kriteri i kërkuar për aftësi të veçanta kërkimore të udhëheqësit në fushën e inxhinierisë së kompjuterave në të cilën parashikohet të hartohet teza.
Konkluzione: Departamentit të Inxhinierisë së Kompjuterave ka një personel akademik me kualifikim të lartë i cili mbulon drejtimet e propozuara të programeve të studimit e në mënyrë të veçantë përgatitjen e tezës.	
Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;	Kandidati për staf ndihmës (asistent kërkimor) duhet të jetë i diplomuar të paktën nga një program Master (Diplomë e Nivelit të Dytë ose Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë.) Asistenët e kërkimit kontribuojnë në aktivitetet e edukimit të Universitetit. Ata bëjnë detyra të tilla, si: konsulentë të studentëve, mbikëqyrës në provime, si dhe ndihmojnë gjatë orëve të mësimit dhe laboratorit.
Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Një nga qëllimet strategjike të Universitetit Epoka është: - Të sigurojë përshtatshmërinë dhe zhvillimin e vazhdueshëm të burimeve njerëzore esenciale në realizimin e misionit, strategjive dhe objektivave. - Përdorimi efektiv i shërbimeve administrative dhe mbështetëse me qëllim arritjen e objektivave strategjike;
Konkluzione: Personeli ndihmës shkencor dhe administrative kontribon fuqishëm për realizimin e mbështetjen e procesit mësimor në diplomat parkatëse të nivelit të dytë. Personeli ndihmës shkencor (asistentët e kërkimit) mbështet kryesisht për konsulentë të studentëve, mbikëqyrës në provime, si dhe ndihmojnë gjatë orëve të mësimit dhe laboratorit, ndërsa personeli ndihmës administrative kontribon në menaxhimin e gjithë aktiviteteve ndihmëse dhe jetës universitare.	
Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;	Mendojmë se ngarkesa mësimore realizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. (Udhëzimi Nr.20, datë 09.05.2008, “Për veprimtarinë e personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, nuk mund të aplikohet në këtë institucion privat)
Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi i drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.	Ngarkesa mësimore e detyrueshme përcaktohet në kontratën e punës dhe është për Prof.Dr. 12 orë, Prof.Asoc.Dr. 14 orë, Asistent kërkimor 18 orë, Lektor 20 orë. Ngarkesa mësimore shtesë paguhet në pazë të rregullave për pagesat e orëve shtesë.
Konkluzione: Përgjithësisht mund të thuhet se personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në mënyrë të veçantë në kontratën e punës.	

Megjithatë, jemi të mendimit, që në kushtet e angazhimit edhe në kërkimin shkencor, ngarkesa mësimore javore është relativisht e lartë.	
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;	Zyra e Burimeve Njerëzore administron dosjet që përmbajnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të Universitetit Epoka, si dhe menaxhon dhe vazhdimisht përditëson bazën elektronike të të dhënave mbi stafin e Universitetit. Në mënyrë më të detajuar Departamenti dhe sekretaria mësimore disponojnë gjithë informacionin për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në programet përkatëse të studimit.
Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;	Menaxhimi i aktivitetit mësimor kryhet nga sekretaria mësimore në bashkëpunim me Departamentin përkatës. Sekretaria mësimore disponon një sistem modern informacioni, Sistemi i Informacionit i Sekretarisë Mësimore (SISM) që është një sistem interaktiv ku studentët dhe stafi mund të kryejnë pjesën më të madhe të procedurave me anë të kompjuterëve. SISM përfshin informacionin në lidhje me regjistrimin, kurset, etj. si dhe gjithë informacionin e nevojshëm për studentët, stafin dhe infrastrukturën fizike të Universitetit.
Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.	Procesi i rekrutimi të stafit menaxhohet nga Këshilli i Administrimit të Universitetit, i cili shpall vendet e lira, llojin e vendit të lirë (me kohë të plotë ose të pjesshme), si dhe të gjitha karakteristikat dhe kushtet e tjera të nevojshme që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për një vend të lirë pune, në të cilin kërkohet titulli Doktor, Docent, Profesor i Asociuar dhe Profesor. Në të njëjtën kohë, procedurat dhe data e mbylljes së aplikimeve shpallen në mënyrë të qartë.
Konkluzione: Universiteti EPOKA disponon një sistem modern informacioni i cili ndërmjet të tjerash realizon edhe menaxhimin e informacionit për personelin.	
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;	Në objektivat strategjike të Universitetit Epoka ndër të tjera përcaktohet: - Të jetë një universitet i përshtatshëm dhe efektiv gjatë realizimit të misionit, strategjive dhe objektivave sipas mundësive dhe burimeve dhe në marrëdhënie me personat e interesuar dhe kualifikimin e stafit dhe të studentëve; Universiteti Epoka ka përcaktuar qartë kërkesat dhe procedurat për rekrutimin e stafit akademik e për mbështetjen e tij me programe kualifikuese.

Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.	Universiteti Epoka ofron i mundëson personelit akademik (sidomos atij të ri) kualifikime si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Një kontribut të veçantë në këtë drejtim jep organizimi i seminareve me lektorë vendas e të huaj si dhe organizimi i një numri të konsiderueshëm konferencash.
Konkluzione: Angazhimi i Universitetit Epoka në kualifikimin e personelit përcaktohet si një prej objektivave strategjike të tij.	
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	Në Universitetin Epoka, infrastruktura teknologjike dhe teknologjitë e informacionit përdoren në nivelin më të lartë.
Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	Universiteti Epoka disponon një sistem informacioni - Information Systems Center (ISC) i cili është funksional që prej vitit 2009. Sistemi i shërben mësimin, dhe kërkimit shkencor, duke plotësuar nevojat në nivel shumë të mirë.
Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.	Zyra e IT e Universitetit Epoka ka krijuar një arkivë elektronike përveç asaj fizike ekzistuese.
Konkluzione: Universiteti Epoka disponon një sistem informacioni i cili i shërben mësimin, dhe kërkimit shkencor, duke plotësuar nevojat në nivel shumë të mirë.	
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	Pranimi i studentëve në programet e ciklit të dytë kryhet nëse studenti minimalisht zotëron një diplomë të ciklit të parë ose diplomë të sistemit të mëparshëm të pandarë në cikle studimi.
Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;	Programet e studimeve DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike nuk janë programe të integruara studimesh, por janë programe studimi të ciklit të dytë.
Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;	Pranimi i kandidatëve kryhet në bazë të vlerësimit të rezultateve të studimeve universitare, të provimit të gjuhës së huaj, intervistës ose provimit të aftësive të veçanta. Studentët të cilët zotërojnë një diplomë të ciklit të parë, duhet të kryejnë vlerësimin e programit të studimit të cilin kanë ndjekur. Këshilli Administrativ i Fakultetit cakton Komisionin Shkencor që do të kryejë vlerësimin e diplomës së ciklit të parë. Eventualisht mund të përcaktohen edhe lëndët/kreditet që duhen

	plotësuar (më pak se 60 kredite ECTS). Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin në fuqi, Komisioni Shkencor mund të njohë si kredite të formimeve universitare deri në maksimumi 40 kredite ECTS të njohurive të veprimtarive formuese të fituara më parë nga ana e studentit, të cilat janë në përputhje me objektivat specifike të programit përkatës të studimit.
Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve; Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.	Studentët e pranuar i nënshtrohen provimit të gjuhës angleze të mbajtur nga Universiteti Epoka, në mënyrë që të verifikojë nivelin e mjaftueshëm të anglishtes. Studentët të cilët në provimet ndërkombëtare, si provimi i TOEFL, kanë marrë IBT 68, CBT 190, PBT 520 pikë, në provimin akademik IELTS janë vlerësuar me notën 5.5, Cambridge (CPE) Nota C dhe lart e më sipër dhe janë të pajisur me certifikatat përkatëse, mund të fillojnë programin mësimor universitar pa u futur në provimin e gjuhës. Studentët të cilët nuk kalojnë provimin e gjuhës angleze duhet të ndjekin programin përgatitor të gjuhës angleze.
Konkluzione: Në Universitetin Epoka studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë nëse minimalisht disponojnë një diplomë të ciklit të parë si dhe në bazë të kriterëve të tjera specifike që lidhen me fushën e studimit. Një kriter të veçantë përbën edhe zotërimi i gjuhës angleze, duke qenë se mësimet zhvillohen në gjuhën angleze.	
Standardi IV. 2 - Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.	
Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;	Mundësitë e punësimit përcaktohen qartë dhe shoqërojnë sillabusin e diplomave përkatëse.
Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;	Nëpërmjet faqes së internetit të Universitetit Epoka si dhe sistemit të informacioni të institucionit, studentëve u ofrohet një informacion i mjaftueshëm për diplomën.
Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.	Në Universitetin Epoka funksionon <u>Qendra e Formimit të Vazhduar dhe Planifikimit të Karrierës</u> funksionet kryesore të së cilës janë organizimi i seminareve dhe kurseve me qëllim zhvillimin e individit, institucionit ose organizatës; shërbimi i këshillimit në lidhje me transferimin e ideve dhe praktikave të reja tek strukturat dhe individët e institucionit; realizimi i projekteve në fusha të ndryshme të ekspertizës si dhe lehtësimi i procesit të punësimit të të diplomuarve dhe menaxhimi i marrëdhënieve me të diplomuarit nga Universiteti.

Konkluzione: Faqja e internetit e Univesitetit Epoka, Sistemi i Informacionit si dhe Qendra e Formimit të Vazhduar dhe Planifikimit të Karrierës kontribuojnë për informimin e studentit gjatë studimeve në universitet dhe orientimin e tij drejt tregut të punës. Mësimdhënia në gjuhën angleze lehtëson mjaft komunikimin dhe shkembimet me universitete të tjera jashtë Shqipërisë, duke mundësuar formimin e studentëve jo vetëm për tregun kombëtar, por edhe atë rajonal e më gjerë.	
Standardi IV. 3 - Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;	Për programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike disponohen statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuar. Duhet theksuar se deri më tani numri i studentëve të diplomuar në këtë cikël ka qenë realativisht i kufizuar.
Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;	Për programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike disponohen statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar.
Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.	Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për mbajtjen e shënimeve akademike të tilla si përpunimi i transkripteve, verifikimi i regjistrimit, mbajtja e shënimeve në bazën e të dhënave të studentëve, përpunimi i listave të klasës, aplikimi i diplomimit etj.
Konkluzione: Universiteti Epoka disponon një sistem informacioni modern i cili, ndërmjet të tjerave, shërben për menaxhimin e gjithë procedurave që kanë të bëjnë me studentin (programet e studimeve, ecurinë akademike të studentëve, diplomimin etj.).	
Standardi IV. 4 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;	GVJ i mungojnë të dhënat për këtë pikë.
Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.	Për vazhdimin e cikleve të tjera të studimit brenda Universitetit Epoka, Sistemi i Informacionit i Sekretarisë Mësimore shërben si bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë këto cikle, ndërsa për ndjekjen e studentit i cili vazhdon ciklet në vijim në Universitete të tjera brenda apo jashtë vendit, këto të dhëna i mungojnë GVJ.
Konkluzione: Universitetit Epoka disponon bazën e të dhënave për studentët që ndjekin ciklet e ndryshme të studimit në këtë universitet, por GVJ nuk disponon të dhëna për ndonjë bazë të dhënash eventuale në lidhje me	

statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë.	
Standardi IV. 5 - Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;	Sistemi i informacionit i studentit (shih http://eis.epoka.edu.al/) ofron të dhëna të detajuara për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programeve.
Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;	Sistemi i Informacionit i Sekretarisë Mësimore (SISM) (https://sis.epoka.edu.al/) i jep studentit akses në informacione që kanë të bëjnë me vlerësimin në lëndë të ndryshme. Nga faqja hyrëse, duke përdorur Student ID (ose emrin) dhe fjalëkalimin, studentët mund të hyjnë në faqen e tyre SISM.
Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.	Nga ana e studentëve mund të aplikohet për verifikim (eventualisht rishikim) të notës së përfutur në një lëndë, aplikim i cili kryhet me shkrim brenda javës.
Konkluzione: Sistemi i informacionit i studentit dhe sistemi i Informacionit i Sekretarisë Mësimore përbëjnë bazën e informimit dhe komunikimit të studentëve. Kemi të bëjmë me një sistem interaktiv ku studentët dhe stafi mund të kryejnë pjesën më të madhe të procedurave me anë të kompjuterëve. Faqja SISM përfshin informacionin e mëposhtëm në lidhje me informacione kredenciale, mesazhe, regjistrimin, kurse, etj. Në të njëjtën kohë, programi i automatizimit të Universitetit Epoka përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët, stafin dhe infrastrukturën fizike të Universitetit.	
Standardi IV. 6 - Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;	Universiteti Epoka ka ndërmarrë dy iniciativa mbi këshillimin e studentëve të saj. Iniciativa e parë parashikon që studentët e vitit të parë do të marrin ndihmë në formë këshillimi dhe udhëzimi prej studentëve të viteve të larta të cilët janë zgjedhur mentor. Ndërkohë, iniciativa e dytë synon një kalim sa më efektiv të studentëve në prag të diplomimit në jetë profesionale nëpërmjet ndihmës dhe udhëzimeve të Mentorëve të Kualifikuar.
Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.	Në Universitetin Epoka rëndësi e veçantë i është kushtuar organizimit të praktikave për studentët në institucione të ndryshme publike, si dhe në kompani private si brenda dhe jashtë Shqipërisë, kryesisht gjatë sezonit të verës. Një nga fushat kryesore të punës së Qendrës së Planifikimit të Karrierës ka qenë organizimi i programeve të praktikave si dhe organizimin e programeve të ndryshme trajnimi për studentët e Universitetit Epoka për t'i pajisur ata më mirë me aftësitë e nevojshme që do t'i ndihmojnë ata në karrierën e tyre të ardhshme profesionale.
Konkluzione: Universiteti Epoka nëpërmjet Qendrës së Formimit të Vazhduar dhe Planifikimit të Karrierës përkujdeset	

për ecurinë e studentëve si dhe për lidhjen e tyre me tregun e punës.	
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1 - Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;	Procesi mësimor mbështetet në literaturë në gjuhën angleze, me libra origjinalë të autorëve të njohur të fushave përkatëse. Në ndonjë rast mësimdhënësit janë edhe autorë, por kryesisht punohet me libra të autorëve të njohur të fushës përkatëse.
Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;	Biblioteka e Universitetit Epoka ka një sipërfaqe të konsiderueshme ku përfshihet fondi i librave, revistave dhe materialeve të tjera, si dhe sipërfaqja e studimit në dispozicion të studentëve dhe stafit.
Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;	Universiteti është bërë një anëtar i bazës së të dhënave të EBSCOhost, që ofron konsultim për dhjetra mijra tekste online. Personeli dhe studentët e Universitetit Epoka kanë akses në burime të siguruar nga EBSCOhost nga çdo kompjuter, pasi të kenë marrë një fjalëkalim nga administrata e Bibliotekës.
Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;	Biblioteka ka një larmi librash të degëve të ndryshme (me mbi 200 tituj/profil) dhe disponon botime të kohëve të fundit me një fond në zhvillim të vazhdueshëm.
Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.	Biblioteka është në dispozicion të studentëve orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e tyre. Nga ana tjetër funksionon shërbimi « on line » i cili është në dispozicion në mënyrë të vazhdueshme.
Konkluzione: Universiteti Epoka disponon një bibliotekë në zhvillim të vazhdueshëm, me një larmi librash të degëve të ndryshme (me mbi 200 tituj/profil) dhe disponon botime të kohëve të fundit. Gjithashtu, universiteti është bërë një anëtar i bazës së të dhënave të EBSCOhost, që ofron konsultim për dhjetra mijra tekste online.	
Standardi V. 2 - Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.	
Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;	Konstatimi i GVJ është se mjediset aktuale janë moderne dhe me hapësira funksionale për zhvillimin e të gjitha veprimtarive universitare. Po ashtu zhvillimi i infrastrukturës ndërtimore synon ta shndërrojë Universitetin Epoka në një pol të zhvillimit të dijes. Infrastruktura ndërtimore mbështetet nga një infrastrukturë moderne laboratorike e shërbimesh.
Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;	Objektet e Universitetit Epoka janë konstruktuar në një mënyrë bashkëkohore me materiale cilësore, duke plotësuar kushtet higjienosanitare për studentët, personelin akademik dhe

	administrativ. Materialet e përdorura nuk përmbajnë elementë të rrezikshëm për shëndetin dhe akustika e mjediseve është e përshtatshme për procesin mësimor. Në ambientet e Fakulteteve ka salla të mëdha leksionesh, salla për seminarët, zyra të pajisura shumë mirë për punonjësit akademikë, për punonjësit ndihmës dhe mbështetës, salla për kompjuterat, ku ofrohet shërbimi i internetit për studentët dhe për stafin akademik, bibliotekë dhe sallë leximi, etj. Universiteti Epoka për vitin akademik 2010-2011 është zhvendosur kryesisht në ambientet e reja të kampusit universitar që ka filluar të ndërtohet në vitin 2009. Ka hyrë në funksionim ndërtesa e parë në kampus, e cila përfshin ambiente mësimdhënieje, zyra moderne si dhe një kafeteri dhe mensë (sipërfaqe e brendshme prej rreth 6200m²). Ndërkohë, ndërtimi i ndërtesave të tjera pritet të materializohet në disa faza brenda një periudhe afatshkurtër.
Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;	Për programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike janë në dispozicion 2 laboratorë kompjuterash me nga 24 PC secili si dhe laborator i elektronikës me një numër paisjesh si oshiloskopë, multimetra etj. për kryerjen e eksperimenteve të ndryshme.
Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.	Nga sa më sipër rezulton se programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike disponojnë bazën e nevojshme laboratorike.
Konkluzione: Në Universitetin Epoka mjediset aktuale janë moderne dhe me hapësira funksionale për zhvillimin e të gjitha veprimtarive universitare. Programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike disponojnë bazën e nevojshme laboratorike.	
Standardi V. 3 - Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;	Një kujdes i veçantë i tregohet zhvillimit të praktikave dhe stazheve verore duke ofruar mundësinë e zhvillimit të tyre në kompani të rëndësishme e të mirënjohura në Shqipëri si dhe jashtë saj (kryesisht në Turqi). Gjatë programit të praktikës, studentët fitojnë shumë përvojë dhe njohuri praktike. Studentët mësojnë në praktikë sistemin e punës dhe organizimin e kompanive në aspektin organizativ dhe të aktivitetit prodhues ose të shërbimit. Gjithashtu, arrijnë të krijojnë marrëdhënie midis "kolegësh" gjatë programit.
Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie	Studentët e Universitetit Epoka gjatë praktikave, krijojnë shumë lidhje të vlefshme me specialistë që punojnë në fushat në të cilat ata janë të interesuar të punojnë në të ardhmen. Vlen për t’u shënuar

bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.	bashkëpunimi në drejtim të praktikave me kompani të njohura si Albtelecom, Eagle Mobile, Abissnet etj.
Konkluzione: Një kujdes i veçantë i tregohet zhvillimit të praktikave dhe stazheve verore duke ofruar mundësinë e zhvillimit të tyre në kompani të rëndësishme e të mirënjohura. Një pjesë e konsiderueshme e studentëve të angazhuar në këto praktika i zhvillojnë ato jashtë Shqipërisë duke u kompletuar edhe me një eksperiencë ndërkombëtare.	
VI - INSTITUCIONI KA DHE MENAXHON BURIMET FINANCIARE	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.;	Zyra e Financës e Universitetit Epoka çdo vit harton një raport mbi të ardhurat dhe shpenzimet. Shpenzimet detajohen në mënyrë të tillë ku dallohen elementë si: • Shpenzimet e stafit, • Edukimi, kërkimi dhe zhvillimi, • Shpenzimet për blerjen e të mirave dhe shërbimeve, • Taksta dhe fondet e paguara, • Investimet.
Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.	Konstatohet se deri më tani (raporti i fundit ai i 2010-2011) të ardhurat nga tarifat e studentëve kanë qenë më të ulta se shpenzimet e stafit. Tek të ardhurat vend të veçantë zenë ato që e kanë burimin nga sponsorë të ndryshëm (që kanë patur një peshë të madhe në këtë fazë të investimeve të larta fillestare).
Konkluzione: Deri më tani Universiteti Epoka ka dëshmuar se zotëron burime të mjaftueshme financiare për zhvillimin e gjithë aktivitetit mësimor e kërkimor e mbështetës, kjo edhe në sajë të një mbështetje të fuqishme nga sponsorë të ndryshëm.	
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;	Programet e studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike mbulohen nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike i cili koordinon gjithë procesin mësimor me angazhimin e personelit përkatës akademik. Ndërmjet personelit akademik të Departamentit ekziston një nivel i lartë bashkëpunimi në shërbim të realizimit sa më cilësor të programeve të studimeve.
Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së	Sipas RVB, në kuadrin e krijimit të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë në Universitet, duke filluar nga semestri i vjeshtës së vitit

vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.	akademik 2008-2009, e gjithë puna e stafit akademik është vlerësuar nga ana e studentëve në fund të çdo semestri përmes plotësimit të një ankete të përbërë nga kategori të veçanta për vlerësimin e pedagogut, vlerësimin e lëndës, si dhe kënaqësinë e përgjithshme të studentëve përsa i përket çdo lënde të dhënë nga pedagogu përkatës. Rezultatet e anketave të vlerësimit të pedagogëve dhe të lëndës sigurojnë të dhëna sasiore të rëndësishme që janë marrë në konsideratë në lidhje me rinovimin e kontratave me stafin akademik, si dhe në caktimin e këtij personeli në lëndët përkatëse.
Konkluzione: Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike i cili koordinon gjithë procesin mësimor me angazhimin e personelit përkatës akademik garanton një nivel të lartë bashkëpunimi në shërbim të realizimit sa më cilësor të programeve të studimeve. Nga ana tjetër në Universitetin Epoka ekziston një sistem i vlerësimit të performancës së stafit akademik nga ana e studentëve si dhe një sistem pikësimi për vlerësimin e personelit akademik ku merren parasysh, artikujt, prezantimet, librat, përkthimet, redaktimi dhe arbitrimi, referencat, aktiviteti mësimor, këshillimi për tezat, projekte kërkimore të përfunduara, çmime të ndryshme, detyra administrative etj.	
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;	Që prej themelimit të tij, krijimi i një bashkëpunimi të ngushtë me universitetet e tjera publike dhe private të Shqipërisë ka përbërë një qëllim të Universitetit Epoka. Gjithashtu, Universiteti Epoka ka vendosur marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me universitete të tjera si në rajon dhe më gjerë. Kështu, deri më tani, Universiteti Epoka ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe memorandume mirëkuptimi (MoU) me rreth 40 universitete dhe institucione të arsimit të lartë në vende të ndryshme të botës. Këto MoU parashikojnë bashkëpunime ndërmjet universiteteve në lidhje me shkëmbimin e stafit akademik, stafit administrativ dhe studentëve për periodha deri në një vit akademik, bashkë-organizimin e konferencave, seminareve dhe ngjarjeve të ngjashme, bashkëpunimin në çështjet kulturore dhe sportive, etj.
Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;	Që nga themelimi i Universitetit, i është vënë rëndësi zbatimit të procesit të mësimdhënies, që do t'u mundësojë studentëve të krijojnë lidhje me kërkesat e tregut vendas të punës, duke filluar nga studimet e tyre universitare. Në këtë drejtim, rëndësi e veçantë i është dhënë organizimit të praktikave për studentët në institucione të ndryshme publike, si dhe në kompani private si brenda dhe jashtë Shqipërisë, kryesisht gjatë sezonit të verës.
Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtjshme në bashkërendim me punëdhënësit;	Qendra e Planifikimit të Karrierës kontribon në orientimin e studentëve në procesin e zhvillimit të ardhshëm dhe në opinionin e tyre të karrierës. Një

	nga fushat kryesore të punës së Qendrës së Planifikimit të Karrierës ka qenë organizimi i programeve të praktikës, si dhe organizimin e programeve të ndryshme trajnimi për studentët e Universitetit Epoka përt’i pajisur ata me mirë me aftësitë e nevojshme që do t’i ndihmojnë ata në karrierën e tyre të ardhshme profesionale.
Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Universiteti Epoka ka nënshkruar një MoU me Eagle Mobile dhe është në procesin e nënshkrimit të një marrëveshjeje të tillë me Albtelecom. Sipas këtyre marrëveshjeve, Universiteti Epoka do të organizojë programe trajnimi për menaxhimin dhe personelin tjetër të këtyre kompanive dhe ndërkohë, studentët do të përfitojnë nga mundësitë e praktikimit të ofruara nga këto kompani.
Konkluzione: Nga RVB del qartë se Universiteti Epoka është i angazhuar në zhvillimin e një bashkëpunimi të gjithanshëm me institucione të arsimit të lartë si brenda vendit ashtu edhe jashtë vendit me qëllim të shkëmbimit të eksperiencave më të mira në drejtim të formimit të studentëve dhe kërkimit shkencor në kuadrin e realizimit të misionit të tij institucional. Mësimdhënia në gjuhën angleze lehtëson mjaft komunikimin dhe shkëmbimet me universitete të tjera jashtë Shqipërisë, duke mundësuar formimin e studentëve jo vetëm për tregun kombëtar, por edhe atë rajonal e më gjerë.	
VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË	
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;	Universiteti Epoka ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional.
Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;	Në nivel njësie bazë siç është departamenti analizohen programet mësimore, literatura, sistemet e vlerësimit para çdo fillimi të vitit të ri akademik dhe në vazhdim të tij. Nga ana GVJ u konstatua se në fakultet janë institucionalizuar elementë të sistemit të sigurimit të cilësisë, është ngritur dhe funksionon një sistem i plotë i dokumentuar që të garantojë sigurimin e cilësisë në të gjitha aktivitetet e tij, në përputhje me standardet përkatëse.
Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;	Sipas RVB, në Universitetin Epoka sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë është ngritur dhe ka funksionuar me të gjitha strukturat në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë.
Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;	Sikurse përcaktohet edhe në statut, programet dhe planet mësimore janë objekt diskutimesh e përmirësimesh të vazhdueshme, dhe u janë nënshtruar rishikimeve, në përputhje jo vetëm me kërkesat e akteve të reja nënligjore, por edhe duke reflektuar sugjerime që vijnë nga stafi akademik,

	studentët, apo institucionet me të cilat bashkëpunohet.
Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;	Universiteti Epoka synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to. Universitetit Epoka, më 16 janar 2010, iu akordua çertifikata ISO 9001-2008 mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë për shërbimet e ofruara në nivelin e studimeve universitare dhe pasuniversitare.
Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.	Një element i rëndësishëm në drejtim të garantimit të cilësisë është funksionimi i Këshillit të Vlerësimit Akademik dhe Përmirësimit të Cilësisë . Ky këshill, i cili drejtohet nga Rektori dhe përbëhet nga të paktën një Zv/Rektor, dekanet e fakulteteve, kancelari, përgjegjësi i sekretarisë mësimore, një ekspert i huaj dhe një përfaqësues nga organizma studentore, ka përgjegjësi për të siguruar cilësinë e brendshme të Universitetit Epoka. Funksionimi i këtij këshilli bëhet mbështetur në direktivën “Mbi Vlerësimin Akademik dhe Përmirësimin e Cilësisë në Universitetin Epoka” miratur nga Senati dhe Këshilli i Lartë. Qëllimi i kësaj direktive ka qenë përcaktimi i parimeve mbi vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit, hulumtimit dhe çdo shërbim tjetër të ofruar nga Universiteti, krijimi, zbatimi, zhvillimi dhe vlerësimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në kuadër të institucionit.
Konkluzione: Sipas raportit të vetëvlerësimit, në Universitetin Epoka sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë është ngritur dhe ka funksionuar me të gjitha strukturat në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë. Kështu në nivel njësie bazë siç është departamenti analizohen programet mësimore, literatura, sistemet e vlerësimit para çdo fillimi të vitit të ri akademik dhe në vazhdim të tij. Nga ana e vlerësueses u konstatua se në fakultet janë institucionalizuar elementë të sistemit të sigurimit të cilësisë, është ngritur dhe funksionon një sistem i plotë i dokumentuar që të garantojë sigurimin e cilësisë në të gjitha aktivitetet e tij, në përputhje me standardet përkatëse. GVJ dëshiron të vërë në dukje se nga bisedat me drejtuesit e departamenteve dhe me stafin akademik në tërësi, u evidentua vetë-dijësimi institucional për nevojën e përpunimit të vazhduar të proceseve të garantimit të cilësisë. Prania e një kulture institucionale të vlerësimit kritik të vetvetes nëpërmjet organizimit të vlerësimeve të brendshme dhe planifikimit të përmirësimeve të nevojshme, që GVJ e gjeti të shprehur në prova dokumentare, janë garanci për qasjen objektive të institucionit ndaj menaxhimit të cilësisë tani e në të ardhmen.	

Analiza SWOT për implementimin e programit të studimit

Pikat e forta

- Arsimim cilësor
- Mësimdhënie 100% në anglisht
- Cilësia e kurrikulave të ofruara për programet e studimit
- Nivel i lartë i performancës në procesin e mësimin
- Staf akademik cilësor

- Staf akademik me përvojë ndërkombëtare
- Lidhja e fortë e stafit akademik me institucionin
- Vëmendje e veçantë për përgatitjen cilësore të tezës së diplomës, përfshirë edhe një sistem informatik të verifikimit të plagjiaturës
- Vlerësimi i rregullt i performancës së stafit akademik nga studentët
- Disponimi i laboratorëve të përdorur në procesin mësimor dhe kërkimor
- Rritja e numrit të programeve kërkimore financuar nga burime të brendshme dhe të jashtme
- Vlerësimi i saktë dhe i drejtë i performancës së studentëve
- Procesi i përzgjedhjes për regjistrimin e studentëve
- Ofrimi i bursave të pjesshme dhe të plota për të tërhequr studentët e suksesshëm
- Cilësi e mirë e pjesës më të madhe të studentëve të rregjistruar
- Organizimi i vazhdueshëm i konferencave ndërkombëtare, seminarëve dhe ngjarjeve të ngjashme shkencore.
- Përdorimi i literaturës bashkëkohore të autorëve dhe i burimeve të tjera të botuara
- Përdorimi i pajisjeve teknologjike moderne (projektorë, smart board) në procesin e mësimdhënies
- Abonimi i universitetit në baza të ndryshme të dhënash të bibliotekave elektronike
- Lehtësira të shumta mbi aksesin e informacionit dhe në burimet elektronike të informacionit
- Marrëdhënie dhe komunikim cilësor ndërmjet stafit
- Kushtet e përshtatshme fizike në ambientin e punës
- Marrëdhënie cilësore me institucionet publike dhe sektorin privat
- Organizimi dhe implementimi i programeve trajnuese
- Liderhip në programet e shkëmbimit të studentëve midis universiteteve shqiptare dhe të huaja
- Marrëdhënie të institucionalizuara me universitetet e huaja
- Ekzistenca e imazhit pozitiv përballë publikut shqiptar
- Satisfaksion i lartë i studentëve nga Universiteti Epoka
- Mbështetja e stafit akademik dhe administrativ për përmbushjen e misionit të universitetit
- Bashkëpunim i konsoliduar me profesionistë në treg

Pikat e dobëta

- Vështirësi në lidhje me institucionalizimin dhe periudhën e tranzicionit për shkak të themelimit rishtazi të Universitetit
- Vështirësi të menaxheriale që rrjedhin nga diversiteti kulturor i stafit të universitetit
- Vështirësi që rrjedhin nga kryerja e pjesës më të madhe të proceseve dhe operacioneve të punës në më shumë se një gjuhë dhe në pjesën më të madhe, në gjuhë joamtare
- Mungesa e përvetësimit të plotë të kulturës institucionale nga të gjitha njësitë e universitetit
- Burime të kufizuara financiare të Universitetit Epoka për shkak të shpenzimeve të larta gjatë fazës së themelimit
- Mbështetje e kufizuar financiare në lidhje me zhvillimin e kërkimit shkencor dhe pjesëmarrjen në konferenca dhe aktivitete të tjera shkencore
- Shërbime të kufizuara në sektorin e shëndetit, ushqimit dhe aktiviteteve sportive për studentët
- Akses i kufizuar mbi financimet e BE-së për shtetet jo anëtare dhe shtetet kandidate në BE
- Informacion i kufizuar për mundësitë e financimit të jashtëm
- Nivel i ulët i njohurisë së gjuhës angleze nga ana e një pjese të studentëve
- Udhëzime dhe shërbime konsultimi të kufizuara për studentët
- Mungesë e një numri të mjaftueshëm të stafit mësimdhënës ndihmës
- Përpjekje të kufizuara për sigurimin e mbështetjes nga burime të jashtme për zbatimin e projekteve kërkimore
- Fonde të kufizuara për studentët e doktoraturës jashtë vendit
- Mungesa e njohjes së gjuhës shqipe nga pjesa më e madhe e stafit të huaj, që pengon ndjekjen e rregullt të zhvillimeve sociale, ekonomike dhe politike në vend

Kërcënimet

- Rritja e globalizimit e shoqëruar me rritje të konkurrencës në tregjet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë
- Ndikimi i krizës financiare globale në burimet financiare të publikut të gjerë dhe universitetit
- Ndryshimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe nënligjor të arsimit të lartë
- Numri i madh i universiteteve private në Shqipëri
- Të dhënat joreale të tregut të arsimit në Shqipëri
- Konkurenca jo e drejtë në tregun e arsimit të lartë në Shqipëri

Oportunitetet

- Rritja e kërkesës për të diplomuar cilësorë në fushën e inxhinierisë kompjuterike
- Numri i madh i studentëve shqiptarë që studiojnë në SHBA, Europë dhe në universitetet e shteteve të tjera të zhvilluara
- Anagazhimi i autoriteteve të Universitetit Epoka për të siguruar mbështetje dhe lehtësira për studentët dhe stafin që largohet dhe vjen
- Rritja graduale e numrit të programeve të ofruara nga universiteti
- Inicimi i programeve të doktoraturës
- Aprovimi i aplikimit ndaj programit FP7 dhe nisja e implementimit
- Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese
- Implementimi i lëvizjes së lirë të stafit dhe studentëve përmes përfshirjes në TEMPUS, CEEPUS, Erasmus Mundus, Bazileus, Socrates dhe programit FP7
- Rritja e një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me universitetet dhe institucionet
- Rritja e vetëdijes së stafit dhe studentëve për rëndësinë e sigurisë së cilësisë
- Përmirësimi i kulturës së të mësuarit të vazhdueshëm
- Përmirësimi i imazhit të Universitetit me orientim drejt kërkimit
- Prezantimi i programeve të studimit në distancë
- Prezantimi i programeve studimore duale në bashkëpunim me universitete të njohura jashtë shtetit
- Lidhja ndërmjet kurrikulave, kompetencave të fituara nga studentët dhe kërkesës së tregut
- Rritja e interesit të shoqërisë në të mësuarin e vazhdueshëm
- Zhvillimi i infrastrukturës së të mësuarit on-line

Rekomandimet

- Të harmonizohet më mirë orari dhe ngarkesa e mësimdhënjes nga stafi akademik
- Të shikohet mundësia për ofrimin e mësimdhënjes pjesërisht në gjuhën shqipe
- Të intensifikohen përpjekjet për rritjen e numrit të studentëve të pranuar, duke përdorur politika më efektive marketingu,
- Numri i përgjithshëm i disiplinave, të jetë më i kufizuar dhe i fokusuar në disa drejtime kryesore, në mënyrë që studentët të jenë më komodë në gjetjen e vendeve të punës, sidomos në vendin tonë.
- Për programin e studimit MND Inxhinieri Kompjuterike me kohëzgjatje 1 vit dhe me 60 kredite ECTS, plani mësimor duhet strukturuar në mënyrë të tillë që të propozohen lëndë të detyrueshme në koherencë me orientimin e propozuar (për semestrin e parë) duke lënë lëndë me zgjedhje vetëm në semestrin e dytë.
- Puna individuale e studentëve duhet të stimulohet gjatë zhvillimit të procesit mësimor, duke i dhënë përparësi orëve të veçanta të seminareve, prezantimeve me gojë dhe eseve të ndryshme.
- Rekomandohet që të dhënat e perfituara nga KVAPC të analizohen dhe të bëhen pjesë më e drejtpërdrejtë e menaxhimit akademik dhe administrativ të IAL.
- Një profilizim më i qartë i stafit akademik në fusha të caktuara në shërbim të rritjes së nivelit të mësimdhënies.
- Të vazhdohet puna e nisur me bashkëpunimet brenda dhe jashtë duke insitucionalizuar ato me marrëveshje të qëndrueshme edhe në trojet shqiptare

- Te rritet bashkëpunimi me ndërmarrjet prodhuese lider në drejtimet perkatese si brenda vendit ashtu edhe në rajon.
- Të hartohen programe të plota të kërkimit shkencor dhe të zgjerohet pjesmarrja në projekte kërkimi në funksion të ekonomisë shqiptare.
- Literatura shkencore vendase dhe e huaj në bibliotekë është e nevojshme të zgjerohet si nga larmia ashtu edhe nga tirazhi.

KONKLuzion

Universiteti Epoka në një kohë relativisht të shkurtër ka realizuar gjithë bazën e nevojshme për një zhvillim të sukseshëm në vijim duke garantuar cilësinë, transparencën, standartet e mësimdhënies, zhvillimin e kërkimit shkencor, zgjerimin e bashkëpunimit brenda vendit, në rajon e më gjerë. Në këtë mënyrë do të bëjë të mundur realizimin e synimit të tij për t'u kthyer në një pikë referimi për arsimin e lartë privat jo vetëm në Shqipëri por edhe jashtë saj.

Programet e studimit **DND Inxhinieri Kompjuterike** dhe **MND Inxhinieri Kompjuterike** kontribojnë fuqishëm në përgatitjen e inxhinierëve të kualifikuar të cilët do të mbështesin zhvillimet e shpejta të teknologjië së informacionit në dekadat e fundit dhe prioritetet kombëtare në këtë drejtim.

Në përfundim, si ekspert i GVJ **shprehem pa rezerva për akreditimin e programeve të studimit DND Inxhinieri Kompjuterike dhe MND Inxhinieri Kompjuterike** të Universitetit Epoka, duke shprehur bindjen për kontributin e tyre në një përgatitje cilësore teknike e profesionale.

Grupi i Ekspertëve të Jashtëm

1. Prof. Dr. Thoma Korini